

BUXHETIMI I PËRGJIGJSHËM GJINOR NË SHOIPËRI

Një manual për punonjëset dhe punonjësit e
administratës publike qendrore dhe vendore

**SHTATOR
2019**


 **UN** 
WOMEN



TABELA E PËRMBAJTJES

KAPITULLI 1:	
KONCEPTET DHE TERMINOLOGJIA	2
1.1. Hyrje	2
1.2. Nocioni “gjinor” ose “gjinore”	4
1.3. Koncepti i integritimit gjinor	5
1.4. Koncepti i buxhetimit të përgjigjshëm gjinor	9
KAPITULLI 2:	
KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL PËR APLIKIMIN E BUXHETIMIT TË PËRGJIGJSHËM GJINOR NË SHQIPËRI	15
2.1. Buxheti – pasqyrë e politikave	15
2.2. Ligji “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”	22
2.3. Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”	25
2.4. Udhëzimet për aplikimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor	25
2.5. Ligji nr.9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”	26
2.6. Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike 2014 - 2020	27
2.7. Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2016-2020	27
2.8. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015 - 2020	27
KAPITULLI 3:	
ANALIZA GJINORE	29
3.1.Çfarë është analiza gjinore	29
3.2.Komponentët bazë të analizës gjinore.	30
3.3. Kur duhet zbatuar analiza gjinore?	32
3.4. Cilat janë pyetjet që duhet të studioni gjatë analizës gjinore	33
3.5. Bërja e “pyetjeve gjinore”	35
3.6. Kush është përgjegjës për kryerjen e analizës gjinore?	37
KAPITULLI 4.	
BUXHETIMI DHE MONITORIMI	40
4.1. Monitorimi, vlerësimi dhe llogaridhënia	40
4.2. Përqasja me pesë hapa	41
4.3.Treguesit	42

KAPITULLI 1



KONCEPTET DHE TERMINOLOGJIA

1.1. Hyrje

Ky manual u përgatit nga zyra e UN Women në Shqipëri, në kuadër të zbatimit të projektit "Nxitja e Politikave të Përgjigjshme Gjinore në Evropën Juglindore" financuar nga Agjensia Austriake për Zhvillim (ADA). Qëllimi i tij është t'iu vijë në ndihmë punonjëseve dhe punonjësve të administratës publike në nivel qendror dhe vendor, për të kuptuar, mbështetur dhe zbatuar planifikimin, buxhetimin, (ri)alokimin, shpenzimet dhe monitorimin e burimeve financiare, nën perspektivën dhe këndvështrimin gjinor. Si i tillë, ky manual nuk është një produkt vetëm për specialistet dhe specialistët e financave dhe ekonomisë; integrimi i perspektivës gjinore dhe aplikimi i buxhetimit të përgjigjshëm gjinor si mjet për arritjen e barazisë gjinore, kërkojnë që të arrihet njëkuptim ipërbashkët dhe angazhim të specialisteve dhe specialistëve të të gjitha fushave në institucionet qendrore e vendore.

Buxheti është njohur e pranuar botërisht si mjeti më i fuqishëm për arritjen e objektivave të zhvillimit, që vepron dhe si tregues i angazhimit të qeverisë kundrejt politikave të caktuara. Buxheti kombëtar pasqyron mënyrën se si qeveria (qendrore apo vendore) mobilizon dhe alokon burimet publike, si dhe mënyrën se si ajo

(pra qeveria) synon të plotësojë nevojat sociale dhe ekonomike të popullsisë. Buxheti është instrumenti kryesor që pasqyron mënyrën se si një qeveri administron përparësitë dhe demonstroi seriozitetin e saj në përgjigje të sfidave të vazhdueshme të zhvillimit të tilla si: pabarazia gjinore, varfëria, përgjashtimi dhe padrejtësia ekonomike. Si i tillë, ky mjet nuk mund dhe nuk duhet të përgatitet vetëm nga specialistet dhe specialistët e financave dhe ekonomisë; identifikimi i nevojave sociale të grupeve të cenueshme; prioritarizimi i tyre; sugjerimi i mënyrave të adresimit sa më efektiv dhe korrekt të shqetësimeve dhe nevojave të identifikuar; planifikimi i hapave që duhet të ndiqen për të adresuar një politikë të caktuar; sigurimi dhe matja e përputhshmërisë së saj me legjislacionin dhe politikën në fuqi; të vepruarit brenda kompetencave institucionale; identifikimi dhe matja e treguesve të efektivitetit të ndërhyrjes; zbatimi në praktikë i masave të sugjeruara; matja e ndikimit të menjëhershëm dhe afatgjatë; si dhe matja e nivelit të adresimit të shqetësimit; apo nivelit të kënaqshmërisë së publikut për shërbimin e ofruar, janë të gjitha detyrime e përgjegjësi të tërësisë së stafit të institucioneve qendrore e vendore; ndërkohë që përkthimi i të gjitha këtyre veprimeve në vlera financiare, si dhe planifikimi, alokimi dhe shpenzimi i tyre në kohën e duhur dhe sipas destinacionit të përcaktuar, është përgjegjësi e kombinuar e specialisteve dhe

6 BUXHETIMI I PËRGJIGJSHËM GJINOR NË SHQIPËRI

specialistëve të financave dhe ekonomisë si dhe e drejtuesve dhe drejtuesve të institucioneve përkatëse qendrore e vendore.

Politikat buxhetore qeveritare luajnë rol kryesor në arritjen e objektivave të barazisë gjinore. Literatura e shkruar dhe botuar, si studimet e bëra ndër vite në këtë fushë, vërtetojnë se politikat buxhetore kanë ndikim të ndryshëm te gratë dhe burrat, për shkak se të dyja këto gjini luajnë role të ndryshme në shoqëri dhe po kështu demonstrojnë dhe sjellje të ndryshme konsumatore (Barnett dhe Grown, 2004). Përgjithësisht, politikat qeveritare makro (veçanërisht politikat fiskale – shpenzimet publike dhe taksat) mund të kenë një ndikim domethënës në boshllëqet gjinore të një tërësie treguesish të lidhur sidomos me shëndetësinë, arsimin dhe të ardhurat. Për shembull një diskutim dhe sqarim mbarëbotëror i ngritur kohë më parë, lidhet me politikën tatimore e cila mund të jetë e njëanshme ndaj grave, sepse ka tendencë të rritë incidencën e taksimit të grave më të varfëra, ndërsa nuk arrin të gjenerojë të ardhura të mjaftueshme për të financuar programet e nevojshme për të përmirësuar jetën e këtyre grave (Barnett and Grown, 2004).

Shoqëritë botërisht nuk janë të barabarta, si ekonomikisht ashtu dhe në aspektin shoqëror e politik, pikërisht për shkak të normave të gjinizuara, roleve gjinore të hamendësuar, paragjyqimeve dhe një sërë elementesh të tjerë të lidhur me aftësinë e kufizuar, etninë, identitetin gjinor dhe orientimin seksual ndryshe, etj. Këto pabarazi synohen që të luftohen përmes hartimit dhe zbatimit të një legjislacioni antidiskriminues, apo të politikave publike të mbrojtjes sociale, që synojnë: qasje të barabartë në tregun e punës; paga të barabarta për punë të njëjta e me të njëjtën cilësi; balancim të detyrimeve dhe përgjegjësisve në jetën familjare, apo dhe balancimin në përfaqësimin e burrave dhe grave në vendimmarrjen politike e në jetën publike. Përgatitja dhe vënia në jetë me efektivitet e politikave të tilla varet shumë nga niveli i

analizës të kryer për të kuptuar sa dhe si politika e veprime të tilla ndikojnë në jetët e burrave dhe grave të një shoqërie, si dhe cilat janë efektet e zbatimit të tyre. Nëse veprime e politika të tilla nuk paraprihen nga një analizë e thelluar me këndvështrim gjinor, zbatimi i tyre në praktikë nuk do të sjellë përmirësim të situatës, por përkundrazi do të thellojë më shumë normat e gjinizuara që prodhojnë pabarazinë mes gjinive. Të flasësh me gjuhën e barazisë nënkupton që të pranosh dhe të luftosh që potenciali ekonomik dhe shoqëror i grave dhe burrave me identitete gjinore dhe karakteristika individuale të ndryshme, të mos kushtëzohet përgjatë gjithë jetës pikërisht nga normat e gjinizuara.

Qeveria ka detyrim të punojë për nxitjen e barazisë gjinore, bazuar në tërësinë e instrumenteve ndërkombëtarë të ratifikuar, si dhe në legjislacionin e miratuar dhe politikat kombëtare të hartuara. Në këtë kuadër ligjor dhe të politikave, i duhet kushtuar rëndësi faktit që zbatimi i tyre të arrijë dhe japë rezultate të dukshme në reduktimin e pabarazive pikërisht përmes masave lehtësuese. Megjithatë, jo gjithmonë legjislacioni dhe politikat e hartuara zbatohen në mënyrën e duhur në praktikë.

Realizimi i të drejtave të grave dhe i të drejtave të njeriut kërkon jo vetëm vëmendje ndaj pabarazisë dhe parimit të mosdiskriminimit, por edhe mobilizimin maksimal të burimeve të disponueshme. Nëse i referohemi kuadrit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut, kërkohet që shtetet të marrin në konsideratë ndikimin e pabarazive tek të drejtat dhe nëse është e nevojshme, të ndërmarrin hapa për reduktimin e pabarazive dhe ndikimit të tyre në realizimin e të drejtave të njeriut (Balakrishnan et al. 2016; Elson 2017). Në këtë kuptim, barazia gjinore përdoret si një perspektivë emancipuese, jo thjesht për të mbyllur boshllëqet gjinore por, më tepër për të realizuar në mënyrë progresive të drejtat e grave dhe të drejtat e njeriut, duke mobilizuar maksimalisht burimet e disponueshme. Kur konsideratat e barazisë gjinore njësohen në procesin e përgatitjes

së politikave, shqetësimet dhe nevojat e grave dhe burrave bëhen pjesë integrale e hartimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të politikave dhe programeve në të gjitha fushat. Kjo nënkupton të flasësh me gjuhën e integritit gjinor, e për rrjedhojë të parashikosh dhe mjete të dobishme për realizimin dhe përfshirjen në praktikë të perspektivës gjinore, ose thënë ndryshe, të bësh të mundur që buxhetet e nevojshme për zbatimin e këtyre politikave dhe programeve të marrin në konsideratë dhe çështjet gjinore të shoqërisë.

Të analizosh buxhetin e qeverisë dhe të shqyrtosh ndikimin e tij te gratë, vajzat, burrat dhe djemtë e shoqërisë, apo thënë ndryshe të vlerësosh rolin e buxhetit në nxitjen e barazisë gjinore, nënkupton të përdorësh të ashtuquajturin buxhetim të përgjigjshëm gjinor (BPGJ) si mjet për të integruar perspektivën gjinore në të gjithë hapat e procesit buxhetor – planifikim, hartim, zbatim dhe vlerësim – për të siguruar që politika buxhetore merr në konsideratë çështjet gjinore në shoqëri. BPGJ nuk nënkupton krijimin e buxheteve të ndara për gratë dhe vajzat, apo thjesht rritjen e alokimeve buxhetore të veçanta për këto grupe. Në vend të kësaj, aplikimi i BPGJ nënkupton mbledhjen e të ardhurave buxhetore dhe shpërndarjen e shpenzimeve që adresojnë pabarazitë e vazhdueshme midis grave / vajzave dhe burrave / djemve (Sharp, 2003; Budlender et al, 2002).

Pra nuk mund të themi se aplikimi i BPGJ në praktikë kërkon rritjen numerikisht të barabartë të shpenzimeve që përkushtohen për gratë dhe burrat në një fushë të caktuar. Kjo pasi gratë dhe burrat kanë nevojat të ndryshme në fusha të ndryshme të jetës dhe adresimi e plotësimi i tyre sigurisht që kërkon shpërndarje të ndryshme të shpenzimeve. Pra, jo ndarje numerike e barabartë për secilën gjini (50 përqind për burrat dhe 50 për qind për gratë), por shpërndarje e shpenzimeve në atë formë dhe sasi që t’iu përgjigjen në mënyrë të barabartë nevojave dhe përparësive të grave dhe burrave, si dhe të shërbejnë për të zvogëluar pabarazitë gjinore.

1.2. Nocioni “gjinor” ose “gjinore”

Përpara sesa të fillojmë të flasim me gjuhën e integritit gjinor dhe buxhetimit të përgjigjshëm gjinor, është shumë e rëndësishme të qartësojmë nocionin “gjinor”ose “gjinore”dhe faktin që ai nuk është i njëjtë me fjalën “gjini” që përdoret rëndom në gjuhën shqipe si sinonim i fjalës “seks” për të treguar diferencat biologjike ndërmjet burrave dhe grave.

Seksi (apo ajo që ne shpesh e emërtojmë gabimisht “gjini”) i referohet dallimit biologjik ndërmjet të qenit “mashkull” apo “femër”, dallim ky që bëhet që me ardhjen në jetë të një qenieje njerëzore, nisur nga organet gjenitale. Kjo është një karakteristikë biologjike universale që iu referohet attributeve fizike me të cilat ne lindim dhe që nuk ndryshon në hapësirë (pra në shtete të ndryshme nuk ka përcaktime të ndryshme për një qenie njerëzore të seksit mashkull apo femër) dhe nuk ndryshon as në kohë (pra pavarësisht periudhës kohore që marrim në shqyrtim, si aktualisht, si përpara 20-të, 50-të apo më shumë vitesh, një qenie njerëzore e seksit mashkull apo femër është përcaktuar njëlloj siç përcaktohet sot).

Ndërsa fjala “gjini”ka disa kuptime në varësi të kategorisë së përdorimit. Kështu për shembull: në histori “gjini” i referohet një grupi njerëzish me lidhje gjaku e me prejardhje nga një paraardhës i përbashkët, që ishte dhe njësi ekonomike e shoqërore bazë në komunitetin primitiv; në etnografi, “gjinia” tregon një grup njerëzish me lidhje gjaku, apo vetë këto lidhje (pra fis, farefis apo gjini); në kuptimin gjuhësor “gjinia”është kategori leksiko-gramatikore në një varg gjuhësh, sipas së cilës emrat dhe disa përemra ndahen në mashkullorë dhe femërore(në disa gjuhë edhe “asnjanës”), marrin trajta të ndryshme gjatë lakimit dhe kërkojnë përkim të caktuar kur lidhen me fjalë të tjera, apo dhe kategori gramatikore e mbiemrave, që shfaqet në përkimin e tyre të domosdoshëm me

8 BUXHETIMI I PËRGJIGJSHËM GJINOR NË SHQIPËRI

emrat mashkullorë dhe femërore(ose asnjans) me të cilët lidhen. Po kështu në kuptimin gjuhësor përdorim njëlloj edhe fjalën "gjinore"apo "gjinore"pra trajtë apo mbaresë gjinore.

Kur i referohemi kontekstit zhvillimor apo të të drejtave të njeriut, "gjini" dhe "gjinor", "gjinore" janë nocione kulturore të ndërtaura nga shoqëria rreth dy sekseve biologjike. Pra, nëse një qenie njerëzore që në lindje përcaktohet si e seksit mashkull ose femër, duke iu referuar organeve gjenitale, nocioni "gjini" apo "gjinor", "gjinore" shkon përtej këtij përcaktimi dhe lidhet me pritsmëritë që ka shoqëria për statusin, pozicionin apo rolin që duhet të luajë ky individ i lindur i seksit mashkull ose femër. Kështu "mashkullorë" dhe "femërore" në këtë rast lidhen me çfarë pritet dhe çfarë është e e lejuar apo pranuar (ose dhe e ndaluar) në një shoqëri të caktuar rreth sjelljes, veprimeve dhe marrëdhënieve apo pozitës në familje e shoqëri të një djali/burri dhe vajze/gruaje. Ky kalim nga "individ i seksit mashkull në djalë dhe burrë" apo nga "individ i seksit femër në vajzë dhe grua", është jo vetëm i përcaktuar nga shoqëria, por edhe i ndryshueshëm në varësi të vendit e kohës dhe shpesh shoqërohet me steriotipe që gjithashtu ndryshojnë në shoqëri, vende e kohë të caktuara. Ne të gjithë rritemi me koncepte të ndryshme për mënyrën se si gratë dhe burrat flasin apo sillen në shoqëri. Për shembull jo në pak raste jemi rritur duke besuar se gratë flasin shumë, por nuk thonë fjalë të mençura, apo që detyra e tyre është të bëhen amvisa të mira, të martohen dhe të kujdesen brenda familjes për fëmijët dhe familjarët e tjerë. Po kështu, jo në pak raste kemi dëgjuar apo jemi rritur duke besuar se djemtë dhe burrat nuk qajnë dhe se ata nuk duhet të qajnë, si dhe që burrat janë përgjegjës kryesorë për sigurimin e të ardhurave në familje. Perceptime të tilla ndërtohen nga shoqëria dhe siç e theksuam më sipër ndryshojnë në kohë dhe hapësirë. Për shembull fakti që sot gjithmonë e më tepër theksohet rëndësia e balancimit të përgjegjësive mes burrave dhe grave jo vetëm në jetën publike, por edhe brenda familjes, apo fakti që sot gjithmonë e më tepër burrat po japin ndihmesën e tyre brenda

familjes dhe në rritjen e edukimin e fëmijëve, tregon më së miri që këto role e përgjegjësi të krijuara nga shoqëria ndryshojnë.

Është e rëndësishme të kuptojmë dhe të mbajmë në konsideratë faktin që, nëse diskutojmë mbi çështje që lidhen me (pa)barazinë gjinore, rolet gjinore, diskriminimin gjinor, integrimin gjinor apo buxhetimin e përgjigjshëm gjinor, ne nuk flasim më thjesht për meshkuj dhe femra (siç mund të numërohen për efekt të dokumentimit statistikor), por për burra/djem dhe gra/vajza duke pasur parasysh pozicionin, rolet, pritsmëritë dhe detyrimet që shoqëria u ka caktuar atyre. Ndarja burra dhe gra në këtë rast merr/duhet të marrë gjithashtu në konsideratë dhe faktin që gjinia nuk është i vetmi dallim ndërmjet këtyre grupeve. Kjo nënkupton të marrësh në konsideratë edhe një tërësi karakteristikash të tjera individuale brenda këtyre grupeve, të lidhura me moshën, etninë, vendlindjen/vendbanimin, besimin fetar, aftësitë e kufizuara, identitetin gjinor¹ apo orientimin seksual, statusin civil, etj.,(pra pritsmëritë dhe pozicioni në shoqëri i burrave dhe grave është i ndryshëm jo vetëm ndërmjet, por edhe brenda këtyre grupeve, pikërisht në varësi të karakteristikave individuale të cituara më sipër).

Një politikë, masë apo veprim i caktuar ka perspektivë gjinore nëse ka apo mund të ketë një ndikim në situatën përkatëse të burrave dhe grave. Analiza gjinore është ajo analizë që merr në konsideratë ndikimin (ose ndikimin e mundshëm) të një politike, mase apo veprimi, mbi situatën përkatëse të burrave dhe grave.

Një politikë, masë apo veprim me perspektivën gjinore të integruar, është një politikë, masë apo veprim që përgatitet duke marrë

1. Identiteti gjinor gjithashtu nuk duhet të ngatërrohet me seksin apo gjininë. Ai ka të bëjë me mënyrën se si një individ ndjehet përbrenda dhe se si e shpreh gjininë nëpërmjet veshjes, sjelljes dhe pamjes, pavarësisht nëse është i seksit mashkull apo femër. Pra seksi dhe identiteti gjinor jo domosdoshmërisht përkojnë: një individ edhe pse lind i seksit mashkull, jo domosdoshmërisht ndjehet së brendshmi si djalë apo burrë dhe po kështu edhe për një individ që lind i seksit femër, që jo domosdoshmërisht ndjehet së brendshmi si vajzë apo grua. Madje ka dhe individë që mund të ndjehen përbrenda se u përkasin të dygrupeve gjinore ose asnjërit prej tyre. Ndërsa orientimi seksual tregon se drejt cilit grupim gjinor orientohesh seksualisht (pra drejt vajzave/grave apo djemve/burrave) dhe jo se cili grupim gjinor ndihesh së brendshmi.

në konsideratë ndikimin që do të ketë mbi situatën përkatëse të burrave dhe grave.

1.3. Koncepti i integritimit gjinor²

Integritimi gjinor i është rritur rëndësia që në Konferencën e Katërt Botërore të Grave, të mbajtur në Pekin në vitin 1995, ku dhe u konsiderua në nivel ndërkombëtar si strategjia më e përshtatshme për të nxitur barazinë ndërmjet grave dhe burrave.

Integritimi Gjinor (IGJ) nga Këshilli i Evropës përkufizohet si (ri) organizimi, përmirësimi, zhvillimi dhe vlerësimi i proceseve të politikave, në mënyrë që të përfshihet një perspektivë e barazisë gjinore në të gjitha politikën, në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fazat, nga aktorët normalisht të përfshirë në politikëbërje³. Me fjalë të tjera, kjo nënkupton që, qëllimi përfundimtar, është të bëhet e mundur që të menduarit rreth perspektivës gjinore apo marrja në konsideratë e saj, të vijë si veprime automatikisht së brendshmi të aktorëve të ndryshëm të përfshirë në planifikimin, hartimin, zbatimin dhe monitorimin e vlerësimitin e politikave publike.

Integritimi gjinor është i ndryshëm nga një politikë e veçantë për barazi. Një politikë e veçantë për barazi, është në fakt, qasje kuruese e limituar në një fushë të caktuar dhe bazohet në gjetjet e pabarazisë ndërmjet burrave dhe grave. Ligjet mbi barazinë përbëjnë një shembull të një politike të veçantë për barazi. Këto ligje kërkojnë për shembull barazi ndërmjet burrave dhe grave në përgatitjen e listave të votimeve dhe miratohen me qëllim që të adresohet problemi i mungesës së përfaqësimit apo i përfaqësimit në nivel të ulët të grave në kuvendin legjislativ. Integritimi gjinor, nga ana tjetër, buron dhe bazohet në qasjen parandaluese. Në vend të marrjes së masave të veçanta për të korrigjuar një pabarazi qartësisht të dukshme në një fushë të caktuar (politikë e veçantë për

barazi), të gjithë personave të përfshirë në përgatitjen dhe hartimin e politikave publike u kërkohet të marrin në konsideratë barazinë ndërmjet burrave dhe grave, me qëllim që të parandalojnë krijimin apo thellimin më tej të pabarazive ndërmjet burrave dhe grave, si rrjedhojë e aplikimit të këtyre politikave publike (integritimi gjinor).

Integritimi gjinor nuk ka fund, por është një strategji afatgjatë që synon arritjen e një objekti: pikërisht të fuqizimit të barazisë ndërmjet burrave dhe grave. Për të qenë sa më të saktë, integritimi gjinor në fakt nuk është një qasje që synon t'iu japë më shumë preferencë grave krahasuar me burrat, por një metodë e përgatitur pikërisht për të siguruar që politikën publike hartohen dhe zbatohen duke marrë në konsideratë dallimet dhe pabarazitë e mundshme që ekzistojnë ndërmjet burrave dhe grave, për të fuqizuar kështu barazinë ndërmjet sekseve. Në këtë kontekst, nëse konstatohet se burrat janë në një situatë më pak të favorshme se gratë në një fushë të caktuar, kjo gjë duhet të merret në konsideratë gjatë përgatitjes së një politike apo mase në këtë drejtim. Edhe pse kanë përkufizime të ndryshme nga njëra – tjetra, integritimi gjinor dhe politika e veçantë për barazi nuk janë reciprokisht përjashtuese, por përkundrazi janë plotësuese. Që të veprosh paralelisht me integritimin gjinor, një politikë e veçantë për barazi, mbetet thelbësore për të luftuar dhe reduktuar pabarazitë ekzistuese ndërmjet burrave dhe grave.

Në mënyrë të përmbledhur dallimet ndërmjet politikës së veçantë për barazi dhe integritimit gjinor, jepen në tabelën në vijim (tabela.1):

Në kontekstin e aplikimit të integritimit gjinor (dhe të buxhetimit gjinor) është gjithashtu i nevojshëm të bëhet dallimi ndërmjet politikave publike dhe gjithçkaje që ka të bëjë me funksionimin e brendshëm të administratës. Përgjithësisht integritimi gjinor synon njësimin e perspektivës gjinore në politikën publike pra në të gjitha iniciativat e ndërmarra nga qeveria për të përmirësuar funksionimin e shoqërisë dhe që kanë ndikim tek individët që përbëjnë këtë shoqëri, pra tek burrat dhe gratë, djemtë dhe vajzat, me të gjitha

2. "Manual for the application of gender budgeting within the Belgian federal administration", prepared from the Institute for the Equality of Women and Men, 2010, pg 16-21

3. http://www.coe.int/T/E/Human_Rights/Equality/02_Gender_mainstreaming/

Tabela 1.

POLITIKA E VEÇANTË PËR BARAZI	INTEGRIMI GJINOR
Vendos barazi pas evidentimit të problemit	Merr parasysh barazinë përpara ndërhyrjes
Ka efekt kurues (të zgjidhë problemet e pabarazisë)	Ka efekt parandalues (të parandalojë problemet e mundshme të pabarazisë)
Përqendrohet në një fushë të caktuar	Përqendrohet në të gjitha fushat
Është tematike	Është sistematike
Veprimet e planifikuara kanë si objektiv të veçantë nxitjen e barazisë	Ndërgjegjësimi mbi çështjet gjinore i paraprin planifikimit të veprimeve për nxitjen e barazisë

përcaktimet e sipërpërmendura mes tyre. Pra integrimi gjinor synon të sigurojë që politikat publike, të marrin në konsideratë dallimet dhe pabarazitë e mundshme ndërmjet të gjithë burrave dhe grave në shoqëri.

Politikat publike përgatiten dhe zbatohen nga institucionet publike. Por veprimet që ndërmerren brenda këtyre institucioneve që kanë të bëjnë me organizimin dhe funksionimin e tyre të brendshëm (pagat e personelit, prokurimi i pajisjeve, llogaritë, etj.) nuk janë politika publike sepse nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në shoqëri. Megjithatë qasja e integritit gjinor duhet të aplikohet edhe në planifikimet mbi funksionimin e brendshëm të institucioneve publike.

Integrimi gjinor është më shumë sesa thjesht një strategji për të nxitur barazinë ndërmjet burrave dhe grave. IGJ është një qasje që ndihmuan në krijimin e “qeverisjes së mirë” dhe që bën të mundur rritjen e efektivitetit të politikave publike përmes njohurive të thelluara mbi grupet e synuara dhe analizës së fushave të ndryshme të veprimit nga këndvështrimi gjinor. Prandaj dhe zhvillimi e përdorimi i të dhënave të ndara sipas seksit, statistikave gjinore dhe treguesve të ndjeshëm gjinorë e luajnë rol të rëndësishëm në aplikimin e integritit gjinor. Integrimi gjinor është gjithashtu një proces që përforcon qendrueshmërinë dhe transparencën e politikave publike.

Në terma praktikë, Integrimi Gjinor është:

- Një strategji për të arritur barazinë gjinore brenda programeve/politikave
- Ka të bëjë me masa dhe burime të zakonshme (burime financiare, infrastrukture dhe njerëzore)⁴

Çfarë nënkupton Integrimi Gjinor në punën e përditshme?

Nëse përparësitë për barazinë gjinore janë të përfshira (“integruara”) në politikat, buxhetet dhe ofrimin e shërbimeve publike, kjo do të çonte në:

- Shërbime publike njësoj të arritshme si për gratë edhe për burrat dhe/ose vajzat dhe djemtë
- Shërbime publike që ofrojnë të njëjtën cilësi shërbimesh si grave ashtu edhe burrave dhe/ose vajzave e djemve
- Shërbime publike që sjellin të njëjtat përfitime si për gratë ashtu edhe për burrat
- Shërbimet publike do të sigurojnë që shërbimet që ofrohen trajtojnë nevojat e veçanta si të grave edhe të burrave, duke lejuar masa të posaçme, kur është e nevojshme, për të siguruar që gratë dhe burrat të kenë pikënisje të të njëjtit nivel, kur tentojnë aksesin ndaj këtyre shërbimeve.

4. Bowman, Ann. “Çfarë është Integrimi Gjinor” Prezantim për Workshop të UNIFEM Shqipëri mbi BGJ – Shtator 2008, JamStod, 2008. www.ann-boman.se

Integrimi gjinor është një strategji që kërkon:

- Një proces monitorimi dhe vlerësimi sistematik, si dhe mjete e metodologji praktike që ndihmojnë për ndërtim kapacitetesh dhe monitorim ditë pas dite
- Ngritjen e një mekanizmi llogaridhënieje dhe përkushtimin e burimeve të mjaftueshme
- Zhvendosje të përgjithshme në axhendën e integrimit
- Një proces pjesëmarrës në të cilin të përfshihen promovueset dhe promovuesit e barazisë gjinore

Kushtet e nevojshme për Integrimin Gjinor:

- Vullneti politik
- Aplikimi i angazhimeve kombëtare dhe ndërkombëtare për barazinë gjinore (të tilla si legjislacioni, politikat, strategjitë e planet e veprimit për barazinë gjinore, përfshirë dhe instrumentat ndërkombëtare të ratifikuar në këtë drejtim) në politikat vendore dhe kombëtare (duke siguruar që buxhetet përkatëse t'i pasqyrojnë këto angazhime)
- Një nivel kapaciteti për të vlerësuar, skicuar dhe monitoruar kushtet faktike të grave dhe burrave – në kushte ideale, kjo do të përfshinte përdorimin e të dhënave të ndara sipas seksit, statistikave gjinore dhe treguesve të ndjeshëm gjinorë, por kjo nuk është gjithmonë e nevojshme në fillim të procesit – veçse duhet të jetë rezultat i proceseve fillestare
- Buxhete që mbështesin politika me çështjet gjinore të integruara që gjatë hartimit të tyre

Sfidat:

- Qeveritë mund të ndërpresin politikat e veçanta të barazisë midis grave dhe burrave
- Koncepti i integrimit gjinor mund të reduktohet në dy kategori, burrë-grua, pa marrë parasysh marrëdhëniet ndërmjet tyre
- Mungesa e mjeteve dhe teknikave të nevojshme për zbatimin e tij
- Mungesa e trajnimeve për aktorët e përfshirë

Në kushte ideale, me të filluar procesi i integrimit të përkatësisë gjinore në politikat kyçe dhe buxhetet e tyre nga autoritetet vendore dhe/ose qendrore, lindin kapacitetet dhe përjasjet e mëposhtme:

- **Të kuptuarit dhe përkushtimi** – qartësi mbi synimin e barazisë dhe zhvillimit të gruas si në nivelin e lartë vendimmarrës ashtu edhe nivelet e tjera të jetës politike e publike, si dhe në marrëdhëniet brenda familjes, dhe përkushtimi për ta ndjekur këtë synim si nga ana e institucioneve ashtu edhe e individëve.
- **Strukturat dhe mekanizmat** – për të siguruar që çështjet e zhvillimit të gruas do të ngrihen brenda proceseve planifikuese dhe vendimmarrëse të qeverisjes, për të realizuar lidhjet ndërsektorale, për të monitoruar përparimin, dhe për t'i mbajtur institucionet të përgjigjshme rreth çështjeve të zhvillimit të grave.
- **Informacion, të dhëna dhe punë kërkimore** – vënia në dispozicion e inputeve të nevojshme, të tilla si puna kërkimore mbi situatën e gruas dhe të dhëna të mjaftueshme të ndara sipas seksit, si dhe statistika e tregues gjinorë për të mbështetur formulimin e politikave dhe programeve.
- **Shprehi analitike, planifikuese menaxhuese** – për të identifikuar dhe për t'u përgjigjur çështjeve të zhvillimit të gruas që lidhen me mandatin e institucioneve në nivel qendror e vendor.
- **Mekanizmi pjesëmarrës** – nëpërmjet të cilit gratë dhe promovuesit e zhvillimit të gruas mund të marrin pjesë në vendimmarrje mbi formulimin dhe vlerësimin e politikave dhe programeve.
- **Buxhetet e riorganizuar të politikave** – të tilla që t'u përgjigjen përparësive gjinore të integruara në ato politika.

Kur ndodh integrimi gjinor? – në çdo fazë, sidomos në **planifikim** dhe **zbatim**. Ka ndikim të madh mbi ndërmarrjen e reformave të mëdha ose mbi miratimin e legjislacionit të ri.

Çfarë fushash prek? – shumicën e fushave politike, fushat më të ndjeshme për të arritur barazinë gjinore (p.sh. tregu i punës, arsimit, politikat sociale dhe për familjen, etj.), si dhe fushat e konsideruara si

12 BUXHETIMI I PËRGJIGJSHËM GJINOR NË SHQIPËRI

neutrale nga perspektiva gjinore (p.sh. politikat urbane, transporti, etj.)
Ku aplikohet?— Në të gjitha nivelet e politikave, si në nivelin qendror ashtu dhe në atë vendor.

Si mund të dimë që kemi qenë të suksesshëm në integrimin e perspektivës gjinore?

Suksesi evidentohet nëse programet dhe politikat hartohen dhe zbatohen në mënyrë të tillë që, shërbimet që u ofrohen qytetarëve dhe qytetareve janë:

- Barabar të arritshme
- Të së njëjtës cilësi të lartë
- Me të njëjtat përfitime për gratë dhe burrat

Gratë, përmes masave të posaçme, kanë akses ndaj shërbimeve me mundësi të njëjta (që do të thotë – kur kërkohet, shteti vendos masa të posaçme për të sheshuar pabarazitë mes grave dhe burrave, duke siguruar kështu më shumë se sa “akses të barabartë” por akses real dhe të nevojshëm për gratë).

Një nga vështirësitë e integritit gjinor (dhe të buxhetimit gjinor) trondit saktësisht një nga shtyllat thelbësore të kësaj strategjie, konkretisht atë që pret që aktorët e përfshirë në përgatitjen dhe përcaktimin e politikave publike të mendojnë rreth perspektivës gjinore dhe ta marrin atë në konsideratë në punën e tyre. Gjithsesi jo gjithmonë mund të kesh menjëherë një përgjigje të saktë për lidhjen ndërmjet çështjeve gjinore dhe barazisë në të gjitha fushat, sidomos në ato që nuk kanë një perspektivë shoqërore të qartë. Ndërkaq perspektiva gjinore është dhe duhet përfshirë dhe në fusha të tilla si ekonomia, lëvizja dhe transporti, taksat, çështjet mjedisore, etj. Kështu që punonjëset dhe punonjësit e administratës publike qendrore e vendore duhet të mbahen vazhdimisht të informuar për mënyrën se si mund të integrojnë perspektivën gjinore në fushat përkatëse, jo vetëm duke u këshilluar me studime, manuale apo udhëzues të përgatitur për këtë qëllim, por edhe përmes trajnimeve dhe mbështetjes në aplikimin në përditshmëri të kësaj qasjeje, përmes eksperteve dhe ekspertëve të

specializuar për këtë qëllim. Ndër vite është vënë re se pavarësisht përpjekjeve, integrimi gjinor jo në pak raste mbetet thjesht në fazën e teorisë apo të një paragrafi të shkruar. Ndërkaq në praktikë ekzistojnë mjete, metoda e burime për ta kthyer këtë koncept në një strategji konkrete. Buxhetimi gjinor është një prej tyre.

1.4. Koncepti i buxhetimit të përgjigjshëm gjinor

Integrimi i perspektivës gjinore në të gjitha politikat publike nënkupton që kjo perspektivë është gjithashtu e integruar në sferën buxhetore. Për këtë arsye përdoren termat: “buxhetim gjinor”, “buxhetim i ndjeshëm gjinor”, apo edhe “buxhetim i përgjigjshëm gjinor”. Në vijim në këtë manual do të përdorim termin “buxhetim i përgjigjshëm gjinor” për të theksuar jo vetëm ndjeshmërinë gjinore por edhe rëndësinë e përgjigjshmërisë në kohë e me efektivitet të të gjitha institucioneve, kundrejt çështjeve të ndjeshme gjinore.

Gratë dhe vajzat përballen me forma të ndryshme të cënueshmërisë gjatë gjithë ciklit jetësor. Ato mund të përballen me diskriminim para ose pas lindjes, me dhunë, ngacmim ose abuzim seksual, neglizhim për shkak të varësisë dhe mungesës së qasjes në burime, paragjykime shoqërore, si dhe me shfrytëzim - qoftë ekonomik, politik, shoqëror apo fetar. Ato janë të cënueshme ndaj shfrytëzimit dhe diskriminimit, pavarësisht se ku pozicionohen në spektrin ekonomik dhe shoqëror. Për më tepër, cënueshmëria e tyre rritet ndjeshëm nëse ato janë të varfëra, nëse u përkasin grupeve të disavantazhuara në shoqëri, ose nëse jetojnë në zona të thella e të largëta. Buxhetimi i Përgjigjshëm Gjinor⁵ është një mjet që mund të përdoret për të adresuar këto cënueshmëri. Pabarazitë gjinore që mbështesin pengesat e shumta me të cilat përballen gratë dhe vajzat duhet të identifikohen dhe adresohen përmes procesit të planifikimit, buxhetimit dhe zhvillimit. Në të njëjtën kohë, nevojat e

5. Gender Budgeting Handbook for Government of India [Manual i Buxhetimit Gjinor për Qeverinë e Indisë], përgatitur nga Ministria për Zhvillimin e Grave dhe Fëmijëve, tetor 2015, pg.1-6

burrave dhe djemve nuk duhet të lihen pas dore.

Buxhetimi i Përgjigjshëm Gjnor (BPGJ) është një mjet për integrimin gjnor. Vetë integrimi gjnor e përdor buxhetin si një pikë hyrje për të aplikuar "lentet gjnore" në të gjithë procesin e politikës. Buxhetimi i Përgjigjshëm Gjnor ka të bëjë me formulimin e legjislacionit, politikave, planeve, programeve dhe skemave të ndjeshme ndaj gjnive; alokimin dhe mbledhjen e burimeve; zbatimin dhe ekzekutimin; monitorimin, rishikimin, auditimin dhe vlerësimin e ndikimit të programeve dhe skemave; si dhe me ndjekjen e veprimeve korrigjuese për të adresuar pabarazitë gjnore. Pra është mëse e qartë që buxhetimi i përgjigjshëm gjnor nuk ka të bëjë vetëm me buxhetin dhe nuk është thjesht një veprimtari që kryhet një herë dhe konsiderohet i përfunduar. Buxhetimi i përgjigjshëm gjnor është një proces i vazhdueshëm që duhet të zbatohet në të gjitha nivelet dhe fazat e procesit të politikave. Vetë buxheti është një mjet i fuqishëm brenda këtij procesi që mund të adresojë cenueshmërinë e grave dhe vajzave dhe ta transformojë situatën e tyre.

Buxhetimi i Përgjigjshëm Gjnor gjithashtu pranon që adresimi i pabarazive gjnore nuk mund të bëhet vetëm nëpërmjet formulimit të legjislacionit, programeve dhe skemave të ndjeshme gjnore. Alokimet e duhura monetare janë po aq të rëndësishme për arritjen e rezultateve të dëshiruara. Për shembull, vitet e fundit legjislacioni kundër dhunës në familje në Shqipëri është përmirësuar ndjeshëm, dhe po shkon gjithnjë e më tepër drejt përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare në këtë drejtim (përmirësimet e fundit u kryen në vitin 2018). Megjithatë, trajtimi i rasteve përmes qasjes shumë-sektoriale të koordinuar si dhe menaxhimi i tyre deri në riintegrim kërkon domosdoshmërisht ngritjen e Mekanizmave të Koordinuar të Referimit si dhe të shërbimeve mbështetëse të specializuara, apo edhe të programeve për trajtimin e dhunuesve. Vetëm nëpërmjet këtyre shërbimeve rastet do të mund të menaxhohen me sukses dhe do të shkojnë drejt riintegritimit. Kjo mund të arrihet vetëm nëpërmjet një planifikimi, alokimi dhe shpenzimi në mënyrën e duhur të mjeteve

financiare dhe burimeve të tjera infrastrukturore e njerëzore, në përputhje me kërkesat dhe legjislacionin në fuqi.

Këshilli i Evropës e përkufizon buxhetimin e përgjigjshëm gjnor si "Aplikim të integritit gjnor në procesin buxhetor. Ai nënkupton një vlerësim gjnor të buxheteve, përfshirjen e perspektivës gjnore në të gjitha nivelet e procesit buxhetor dhe ristrukturim të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim promovimin e barazisë gjnore."⁶

Thënë më thjesht, buxhetimi i përgjigjshëm gjnor konsiston në analizën dhe krijimin e buxheteve (duke përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet) duke marrë në konsideratë situatën përkatëse të grave dhe burrave. Ky integrim i perspektivës gjnore duhet të kryhet në të gjitha fazat e ciklit të buxhetit, duke filluar nga përgatitja dhe hartimi i tij, mënyra e alokimit të burimeve dhe shpenzimit të tyre, e deri tek monitorimi dhe vlerësimi i parave të shpenzuara. Këto përkufizime gjithashtu nxjerrin në pah se çfarë nuk është buxhetimi i përgjigjshëm gjnor, pra që nuk është thjesht një numërim i projekteve apo veprimeve që lidhen në mënyrë të veçantë me nxitjen e barazisë ndërmjet burrave dhe grave, por që aplikohet edhe në të gjitha projektet apo veprimet e tjera që nuk lidhen drejtpërsëdrejti me barazinë ndërmjet burrave dhe grave. Buxhetimi i përgjigjshëm gjnor siguron që nevojat dhe interesat e individëve nga grupe të ndryshme sociale trajtohen në politikat e shpenzimeve dhe të ardhurave.

Buxhetimi i përgjigjshëm gjnor është një strategji:

- Për të matur dhe monitoruar ndikimin e politikave/programeve mbi gratë dhe burrat
- Për të përshtatur buxhetet në mënyrë të tillë që të arrihen synime dhe strategji të barazisë gjnore, si dhe që të përmbushen

⁶ Këshilli i Evropës Përfshirja e perspektivës gjnore në procesin buxhetor: Raporti përfundimtar i grupit të specialistëve mbi përfshirjen e perspektivës gjnore në procesin buxhetor (EG-S-GB), Strasburg, EG-S-GB (2004), RAP AN 2005

14 BUXHETIMI I PËRGJIGJSHËM GJINOR NË SHQIPËRI

angazhimet e ndërmarra nga qeveria nëpërmjet strategjive dhe ligjeve të ndryshme

- Për të promovuar një analizë sistematike të politikave të buxhetit publik dhe të politikave të tyre përkatëse

Proçesi i aplikimit të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor përfshin gjashtë faza kryesore:

1. Një analizë të situatës së grave, burrave, vajzave dhe djemve në një sektor të caktuar, për të kuptuar nevojat e tyre të ndryshme bazuar mbi rolet gjinore që luajnë.
2. Një vlerësim të përmasave në të cilat një politikë sektori trajton situatën (e gjinizuar) e përshkruar në hapin e parë.
3. Integrimin e përparësive të grave dhe burrave (bazuar në rezultatet e analizës dhe vlerësimit të bërë në dy hapat më sipër) në politikën sektoriale për të siguruar që kjo politikë iu përgjigjet në mënyrën e duhur nevojave të burrave, grave, djemve e vajzave
4. Një vlerësim të faktit nëse alokimet buxhetore janë të mjaftueshme për të zbatuar politikën nga një përjasje që i përgjigjet perspektivës gjinore.
5. Monitorimi i faktit nëse paratë janë shpenzuar sipas planit, çfarë u krye dhe për kë.
6. Një vlerësim i faktit nëse politika siç është zbatuar e ka ndryshuar situatën e përshkruar në hapin e parë, duke sjellë rritjen e barazisë gjinore.

Pra, proçesi i BPGJ përfshin zbatimin e buxhetit, si dhe monitorimin e vlerësimin për t'u siguruar që nevojat e grave, burrave, djemve dhe vajzave nuk lihen mënjanë gjatë rrugës.

Ai përmirëson:

1. Llogaridhënien e qeverive dhe përfaqësuesve e përfaqësuesve të tyre, në drejtim të barazisë gjinore, nevojave, fuqizimit si dhe të drejtave të gruas.
2. Efiçencën duke siguruar që ata që kanë nevojë më shumë, të

përfitojnë nga shpenzimet publike. Njësitë e vetëqeverisjes vendore shpesh kanë burime të kufizuara dhe mënyra se si këto burime shpërndahen me efiçencë ka rëndësi të posaçme në dritën e këtij fakti.

3. Transparencën dhe uljen e korrupsionit.

4. Pjesëmarrjen e gruas në politikën e planifikimit dhe buxhetimit (kjo mundëson që proceset politikëbërëse të trajtojnë në mënyrë të efektshme nevojat e më të varfërve dhe më të pafuqishmëve).

Në përgjithësi, iniciativat për buxhetim gjinor orientohen kryesisht drejt:

- ndërgjegjësimit të palëve të interesuara për natyrën joneutrale të buxheteve.
- sigurimit të një përgjegjësie më të madhe nga qeveritë ndaj angazhimeve për arritjen e barazisë gjinore.
- ndryshimit të mënyrës sipas të cilës hartohen buxhetet dhe politikat (Sharp, 2003).

Sipas UNESCO (2010), buxhetimi i përgjigjshëm gjinor është i rëndësishëm sepse:

1. Ndhmon për krijimin e të kuptuarit të përbashkët dhe ilustron ekzistencën e pabarazisë në ndikimet buxhetore te gratë në krahasim me burrat;
2. Rrit përgjegjshmërinë dhe përshpejton zbatimin e angazhimeve për barazinë gjinore dhe të drejtat e njeriut;
3. Rrit efikasitetin e buxheteve të qeverisë duke lejuar shpërndarje më të mirë të burimeve financiare. Nëse pabarazitë gjinore në ndikimet buxhetore nuk njihen, ato mund të çojnë në humbje të produktivitetit, si dhe në rënie të cilësisë së tregut të punës, rritjes ekonomike, shëndetit e mirëqenies;
4. Rrit efektivitetin e politikave dhe programeve duke vlerësuar nëse objektivat e deklaruar janë arritur;
5. Çon në transparencë, përgjegjshmëri, parashikueshmëri dhe pjesëmarrje në hartimin dhe realizimin e buxhetit.

Përse duhet aplikuar buxhetimi i përgjigjshëm gjinor?

Arësyeja kryesore për aplikimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor, siç u shpjegua edhe më sipër, natyrshëm rrjedh nga fakti që ai kontribuon në fuqizimin e barazisë ndërmjet burrave dhe grave. Duke qenë se buxhetet janë të ndryshme për institucionet qendrore dhe vendore (secili institucion ka buxhetin e tij) integrimi i një perspektive gjinore në nivelin buxhetor është një mënyrë efektive e përfshirjes së të gjithë administratës (qendrore e vendore) në mbështetjen e politikave të ndjeshme gjinore. Kontrolli i buxheteve gjithashtu përbën një mënyrë efektive të përfitimit të një pasqyre të përgjithshme të politikave, masave dhe veprimeve të financuara nga autoritetet publike. Ndaj dhe analiza e buxhetit nga këndvështrimi gjinor, jep një ide më të qartë të ndërgjegjësimit gjinor të aktorëve politikë e publikë. Në fakt, analiza e buxhetit bën të mundur dhe përcaktimin e sasisë së parave të lëna mënjanë për të mbështetur barazinë ndërmjet burrave dhe grave, si dhe bën të ditur nëse është marrë në konsideratë perspektiva gjinore në çështjet financiare për të cilat përdoren rregullisht paratë. Analiza e buxheteve nga këndvështrimi gjinor mund të evitojë shpenzimet që nuk janë të ndjeshme nga këndvështrimi gjinor dhe që janë joeficiente.

Një tjetër arsye se përse duhet të aplikohet buxhetimi i përgjigjshëm gjinor është se ai nxit një përdorim më të dobishëm dhe më të përqëndruar të burimeve publike, e për rrjedhojë udhëheq drejt "qeverisjes së mirë".

Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor është përshtatur më së miri në traditën e buxhetimit të bazuar në performancë, përmes të cilit linjat buxhetore të propozuara vlerësohen nga rezultatet përfundimtare të pritshme. Ky lloj sistemi i orientuar nga rezultatet i vlerëson buxhetet në bazë të rezultateve konkrete (përqëndruar tek outputet/ produktet dhe rezultatet), në vend të kufizimit të diskutimit vetëm tek rritja apo zvogëlimi i buxhetit të vitit të mëparshëm (përqëndruar tek lënda bazë/inputi). Buxhetimi i bazuar në performancë

mbështetet në parimin sipas të cilit buxheti duhet të jetë në një linjë (i harmonizuar) me politikën. Për këtë arsye procedurat dhe dokumentacioni buxhetor duhet të korrespondojnë që në fillim me objektivat, masat, instrumentet, etj., të politikës që po buxhetohet. Në fund të ciklit buxhetor duhet të vlerësohen rezultatet e arritura dhe të përcaktohet nëse janë arritur edhe objektivat e vendosura, bazuar në strategjinë dhe burimet që u përdorën për këtë qëllim, pra duke vlerësuar edhe kosto-efektivitetin e tyre.

Konkretisht, buxhetimi i përgjigjshëm gjinor i korrespondon analizës së rezultateve të arritura. Përmes tij mund të identifikohen disa shpenzime joefektive dhe për rrjedhojë të përmirësohet dhe cilësia e shpenzimeve publike. Në këtë mënyrë, buxhetimi i përgjigjshëm gjinor vepron në kushte optimale brenda kontekstit të procesit buxhetor, duke marrë në konsideratë rezultatet e strategjisë që u zbatua dhe të burimeve që u përdorën. Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor gjithashtu rrit transparencën e buxheteve sepse identifikon përfituesit e fondeve. Sigurisht që prioritare mbetet ndarja e burimeve nga këndvështrimi gjinor, por kjo analizë gjithashtu qartëson ndarjen më të përgjithshme të parave publike. Po kështu, mekanizmat e kontrollit të lidhura me buxhetimin e përgjigjshëm gjinor bëjnë të mundur ushtrimin e një kontrolli më të mirë mbi mënyrën se si ndahen fondet.

Këta elementë demonstrojnë se buxhetimi i përgjigjshëm gjinor përshtatet më së miri në qasjen e tre "E-ve" në menaxhim. Kjo qasje mat vlerën e një strategjie apo të një veprimi duke përdorur tre kritere: Ekonominë, Efektivitetin dhe Eficencën. Duke marrë në konsideratë perspektivën gjinore në proceset buxhetore, buxhetimi i përgjigjshëm gjinor gjithashtu përputhet me qasjen e re të "4 E-ve"⁷, që veç tre E-ve të mësipërme ka dhe konceptin e drejtësisë (Equity) si parametër të katërt përcaktues. Në këtë qasje një strategji apo veprim vlerësohet vetëm nëse ka pikëzim të lartë për secilin nga të katër kriteret.

7. Nëse do të shqipërohej tërësisht si qasje do të ishte qasja e "3 E-D-së", që në përmbajtje ka katër kriteret, përkatesisht: Ekonominë, Efektivitetin, Eficencën dhe Drejtësinë. Por për efekt të njohjes në mbarë botën si qasja e "4 E-ve", edhe në këtë manual u mendua të citohet si e tillë.

16 BUXHETIMI I PËRGJIGJSHËM GJINOR NË SHQIPËRI

Po kështu, buxhetimi i përgjigjshëm gjinor mund të jetë një mjet që bën të mundur pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtare. Kështu për shembull Platforma për Veprim e Pekinit, i referohet në mënyrë të qartë nevojës për të bërë një analizë të buxheteve për të vlerësuar ndikimin e shpenzimeve tek burrat dhe gratë, si dhe u kërkon qeverive përkatëse të modifikojnë buxhetet e tyre për të garantuar një përdorim të balancuar të burimeve në dispozicion, si dhe akses të barabartë në shpenzimet publike.

Gjithsesi, buxhetimi i përgjigjshëm gjinor nuk konsiston në një procedurë uniformisht të zbatueshme në çdo situatë dhe për çdo objektiv. Metoda e zbatimit të tij varet nga situata në punë, burimet në dispozicion, zbatueshmëria e objektivave, aktorët e synuar, etj. Ndaj dhe vetë objektivi i tij varion nga të treguarit thjesht që shpenzimet nuk marrin në konsideratë perspektivën gjinore, deri tek përgatitja e buxheteve që efektivisht marrin në konsideratë perspektivën gjinore. Metoda dhe qëllimi i punës gjithashtu ndryshojnë nëse buxhetimi i përgjigjshëm gjinor aplikohet në një organizatë ndërkombëtare, një institucion publik apo një organizatë jofitimprurëse.

Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor kërkon të çmontojë normat dhe rregullat gjinore që formojnë kufizime strukturore sociale, si dhe ato të përjetësuara nga praktikat institucionale. Shqetësimet për punën e paguar dhe të papaguar, parashikimin e kujdesit, përdorimin e kohës në mënyra të ndryshme nga gratë dhe burrat, si dhe mosarritja e përfshirjes së punës së papaguar të grave në sistemin kombëtar të kontabilitetit, duhet të jenë thelbësore për analizën e propozimeve buxhetore (Waring 1989; Elson 2016) (tabela 2).

Statistikat e disagreguara nga variablat e kryqëzuar të seksit dhe gjinisë, racës dhe përkatësisë etnike, aftësisë së kufizuar, përdorimit të kohës, klasës dhe statusit socio-ekonomik, statusit të përkujdesjes, punës së papaguar, etj., janë thelbësore për

të informuar në mënyrë të dobishme politikat dhe vendimet buxhetore. Për më tepër, proceset dhe vendimet buxhetore duhet të shikojnë përtej nivelit të lartë dhe të marrin në konsideratë ndikimin në nivelin e individit dhe familjes, për t'u siguruar që vendimet e politikave që do të ekzekutohen nëpërmjet një buxheti të caktuar nuk përforcojnë disavantazhin. Prandaj dhe objektivi i buxhetimit të përgjigjshëm gjinor është të bëjë të dukshme realitetet e ndryshme të jetuara të grave dhe burrave dhe ta integrojë këtë analizë në procesin e politikës që parashikon dhe masat për të eliminuar pabarazinë dhe avancuar barazinë.

Buxheti, si çdo përbërës tjetër ekonomik dhe financiar, krijon iluzionin e një instrumenti me neutralitet gjinor, ngaqë në të nuk përmenden gratë dhe burrat. Mirëpo, buxhetet standarde në fakt, nuk janë neutrale, por të verbër, nga ana gjinore (Elson, 2004. f. 623-42; Elson, 2002), duke qenë se nuk i njohin nevojat dhe interesat e ndryshme, sidomos të grupeve të pambrojtura në shoqëri, përfshirë këtu edhe gratë si grupi më i madh i tillë. Masat në dukje neutrale, që nuk marrin në konsideratë dallimet me bazë gjinore të ndërthurura me kategori të tjera të tilla si moshë, raca, kombësia, orientimi seksual, vendqëndrimi, etj., shpesh mund të kenë një larmi rezultatesh negative për grupet e ndryshme. Shpërfillja e pozitës së veçantë të grave dhe burrave, si edhe i roleve që u cakton shoqëria, mund ta kufizojë pjesëmarrjen e përfituesve nga buxheti dhe t'i thellojë pabarazitë ekzistuese gjatë krijimit të politikave, në vend që të ndikojë në uljen e pabarazive. Buxhete të tilla me verbëri gjinore janë edhe negative nga aspekti gjinor.

Përgjithësisht buxhetet janë formuluar për të trajtuar nevojat e gjithkujt në mënyrë të njëjtë, në dukje neutrale. Si rezultat i teorive tradicionale makroekonomike, politikëbërësit përpiqen të pranojnë se të gjithë individët janë të barabartë, me interesa dhe nevoja të njëjta. Këto koncepte dështojnë në njohjen e dallimeve më të dukshme që rrjedhin prej klasës, përkatësisë gjinore, moshës, racës,

Tabela 2.

BUXHETIMI I PËRGJIGJSHËM GJINOR	
NËNKUPTON	NUK NËNKUPTON
Strategji që prezanton parimin e marrjes në konsideratë të perspektivës gjinore në politika, masa dhe veprime të autoriteteve publike, përmes një analize të buxhetit, duke bërë të mundur kështu rritjen e efektivitetit të tyre	<ul style="list-style-type: none"> ● Buxhete të ndara për gratë dhe burrat
Qasje që ka si objektiv përfundimtar të fuqizojë barazinë ndërmjet grave dhe burrave, si dhe të optimizojë ekonominë, dobinë, eficientë dhe drejtësinë e financave publike	<ul style="list-style-type: none"> ● Shpërndarjen e burimeve financiare 50% për gratë dhe 50% për burrat
Instrument për arritjen e një situatë në financat publike (taksat nga të ardhurat dhe shpenzimet) që merr në konsideratë nevojat dhe pritshmëritë e individëve (gra dhe burra)	<ul style="list-style-type: none"> ● Një mjet për të favorizuar gratë ● Një objektiv në vetvete

etnisë, seksualitetit dhe vendndodhjes gjeografike, duke injoruar kështu faktin që politikat dhe buxhetet kanë ndikime të ndryshme në grupe të ndryshme.

Mungesa e njohjes së dallimeve të mësipërme, ka në veçanti ndikim të konsiderueshëm në sektorët më të varfër dhe më të rrezikuar të shoqërisë. Nga njëra anë, aksesit i tyre ndaj shërbimeve bazë të nevojshme për të përmirësuar kushtet e tyre të jetesës, mbështetet tek shpenzimet qeveritare. Nga ana tjetër, të prapambeturit zakonisht vendosen në periferi të veprimit ekonomik dhe politik. Si rezultat i kësaj, nevojat e të varfërve zakonisht trajtohen nëpërmjet përpjekjesh të veçuara, më tepër të kufizuara, të tilla si programet kundër varfërisë, shërbimet e lëvizshme bazë për shëndetin, ose kredi të vogla për veprimtaritë bujqësore. Ndërkohë që lehtësojnë problemet imediate ekonomike dhe shoqërore, këto përpjekje të veçuara lënë të paprekura pabarazitë, që përshkojnë të gjitha nivelet e marrëdhënieve sociale, ekonomike dhe politike. Për më tepër, shpërndarjet e buxheteve "neutrale" nga këndvështrimi gjinor të orientuara drejt grupeve të veçanta mundet që edhe t'i thellojnë pabarazitë.

Ndërkohë që buxhetet kanë trashëguar verbërinë gjinore në modelet makro-ekonomike dhe në këtë mënyrë kanë ndihmuar transmetimin dhe riprodhimin e paragjyqimeve gjinore, ato gjithashtu ofrojnë dhe një mundësi për të transformuar dhe trajtuar pabarazitë gjinore ekzistuese. Hartimi i buxheteve të përgjigjshme gjinore, në fakt ka të bëjë me përgatitjen e buxheteve me një "fytyrë njerëzore" për gratë, vajzat, djemtë dhe burrat. Ai i shndërron politikat me ndjeshmëri gjinore në zëra dhe kategori buxhetore, të lidhura me burimet e nevojshme për vënien e tyre në jetë dhe shmangien e hendekut mes politikave dhe realizimit të shërbimeve. Për rrjedhojë, procesi i buxhetimit me bazë gjinore, nënvizon përgjegjësinë e shtetit për angazhimet që ka marrë lidhur me vënien në zbatim të barazisë gjinore, përmirësimit të politikave dhe përsheptimit të reformave ekonomike.

Në vijim të sa më sipër, nuk duhet të harrojmë që aplikimi i buxhetimit të përgjigjshëm gjinor tashmë në Shqipëri është një detyrim ligjor (siç do të shpjegohet më tej në kapitullin në vijim të këtij manuali), pra kjo është dhe një arsye më tepër se përse duhet të biem dakord, të familjarizohemi dhe të përdorim në mënyrën e duhur buxhetimin e përgjigjshëm gjinor.



KAPITULLI 2

KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

PËR APLIKIMIN E BUXHETIMIT TË PËRGJIGJSHËM GJINOR NË SHQIPËRI

2.1. Buxheti – pasqyrë e politikave

Çfarë është buxheti i qeverisë?

Një nga sfidat e para në përfshirjen për buxhetimin e përgjigjshëm gjinor është nevoja për të kuptuar se **çfarë është** buxheti i qeverisë dhe **si, kur, dhe nga kush** hartohet dhe zbatohet. Kjo është veçanërisht me rëndësi për specialistët dhe specialistët jashtë strukturave dhe institucioneve qeveritare, të cilët duan të bëjnë studime apo avokati, por është gjithashtu e rëndësishme edhe për punonjëset dhe punonjësit brenda institucioneve publike, për të kuptuar kuadrin më të gjerë të buxhetimit. Të kuptuarit se si funksionon buxheti i qeverisë bën të mundur të përcaktohen pikat hyrëse strategjike, që kanë më shumë mundësi të shpien në ndryshime me ndjeshmëri gjinore në buxhet. Gjithashtu na jep të dhëna për të mësuar si dhe kur të fillojmë dhe cilët nga grupet e palëve të interesuara duhen angazhuar në secilën pikë.

Buxheti i një qeverie është një deklaratë financiare e të ardhurave të pritshme dhe shpenzimeve të synuara të qeverisë për një periudhë të caktuar, zakonisht një vit.

- Të ardhurat janë paratë që qeveria mendon se do të marrë gjatë periudhës së buxhetit. Ato përfshijnë taksat, kontributet e sigurimeve shoqërore, pagesat apo tarifatat për shërbimet dhe paratë nga burime të ndryshme, si interesi nga huatë e qeverisë.
- Shpenzimet janë paratë që qeveria synon të shpenzojë. Ato përbëhen nga dy pjesë:
 - Shpenzimet rrjedhëse që përfshijnë shpenzimet për pagat e punonjëseve dhe punonjësve publikë, sigurimin e mallrave dhe shpenzimeve, sigurimet shoqërore (për shembull, në formën e granteve), subvencionet dhe interesin nga borxhi kombëtar. Këto janë para që zakonisht caktohen dhe shpenzohen brenda një viti të caktuar buxhetor.
 - Shpenzimet kapitale të cilat përfshijnë shpenzimet për

20 BUXHETIMI I PËRGJIGJSHËM GJINOR NË SHQIPËRI

infrastrukturën. Këto akordime parash mund të shpërndahen në disa vite buxhetore, meqenëse një projekt në infrastrukturë mund të vazhdojë për më shumë se një vit deri sa të përfundojë.

Funksionet kryesore ekonomike të buxhetit

Përtej sigurimit të llogaridhënies së qeverisë përpara legjislaturës për të ardhurat dhe shpenzimet e saj, dhe me qëllim që të shërbejë si një mekanizëm për kontrollin e shpenzimeve, buxheti ka tre funksione kyçe ekonomike:

- Caktimi i burimeve financiare
- Shpërndarja e të ardhurave dhe pasurisë
- Stabilizimi i ekonomisë

Këto funksione mund të ndahen sipas niveleve të ndryshme të qeverisë: kombëtare, qendrore dhe lokale. Buxhetet në të gjitha këto nivele duhen të shqyrtohen për të dhënë një ide të plotë të asaj që qeveria bën ose jo.

Caktimi i burimeve

Ky funksion lidhet me sigurimin e mallrave dhe shërbimeve publike nga qeveria. Të gjitha mallrat dhe shërbimet prodhohen ose nga sektori publik, sektorët formalë dhe informalë ekonomikë, ose nga komuniteti jo fitimprurës dhe sektorët e përkujdesjes së papaguar në familje. Në caktimin e burimeve, qeveria duhet të vendosë si madhësinë relative të sigurimit të sektorit publik, ashtu edhe mënyrën e ndarjes së burimeve ekzistuese midis politikave, programeve dhe funksioneve të ndryshme të qeverisë (p.sh. administratë, shëndetësi, arsim dhe mbrojtje). Alokimet në disa prej këtyre sektorëve do të jenë më shumë për të mirën e grave dhe vajzave se të burrave dhe djemve dhe e kundërta. Buxhetimet e Përgjigjshme Gjinore kërkojnë të zbulojnë ndikimet e alokimeve financiare ndaj grave, burrave, vajzave dhe djemve. Është me

rëndësi të kemi të dhëna të ndara sipas seksit me qëllim që të shihet si ndikojnë ato në grupe të ndryshme.

Shpërndarja e të ardhurave dhe pasurisë

Ky funksion i referohet përdorimit të politikës fiskale dhe buxhetit për të trajtuar pabarazitë në shpërndarjen e të ardhurave dhe pasurisë në shoqëri. Qeveritë duhet të marrin vendime në lidhje me atë që përbën një shpërndarje "të drejtë" midis grupeve të ndryshme. Ndërsa qeveritë ndonjëherë kanë shfaqur shqetësim rreth pabarazive midis familjeve të pasura dhe të varfra, ato gjithashtu duhet t'iu kushtojnë vëmendje pabarazive midis grave dhe burrave dhe midis anëtarëve të secilës familje, meqenëse anëtarët më të cënueshëm të familjeve kanë më pak qasje në burimet ekzistuese. Buxhetimet e Përgjigjshme Gjinore mbështeten në prezumimin se duhet të ketë në shpërndarje të "drejtë" të të ardhurave dhe pasurisë.

Stabilizimi i ekonomisë

Ky funksion i përgjigjet nevojës që buxhetet e qeverisë të nxisin një nivel të caktuar punësimi, shpenzimesh publike, zhvillimi ekonomik, qëndrueshmëri mjedisore dhe ekuilibrit të jashtëm. Politika e stabilizimit kërkon përdorimin e gjykimeve ekonomike, politike dhe shoqërore për të përcaktuar se cilave objektiva u duhet dhënë përparësi dhe cilat janë normat e pranueshme të interesit, nivelet e borxhit dhe kështu me radhë. Një analizë e buxhetimit kërkon një mirëkuptim të mënyrave në të cilat politika makroekonomike, kuadri i saj teorik dhe hamendësimet mbi të cilat mbështetet buxheti, nuk i marrin parasysh çështjet e gjinisë, sidomos rolin e grave në familje dhe në ekonominë e përkujdesit në komunitet. Rritja ekonomike nuk është një qëllim në vetvete, por një mjet për rritjen e burimeve për të përmirësuar mirëqenien në familje. Buxhetet nuk janë as "një qëllim" në vetvete. Prandaj, detyra e parë për përgatitjen e një buxheti duhet të jetë përcaktimi i politikave dhe objektivave të cilat synon të realizojë buxheti. Buxhetet duhet të ndjekin politikat dhe jo e kundërta. Në rast se politika është me të meta, atëherë buxheti do të jetë difektoz.

Kuadri i Shpenzimeve Afatmesme

Gjatë viteve të fundit, shumë qeveri kanë filluar të hartojnë një kuadër shpenzimesh afatmesme i quajtur ndryshe Plani Buxhetor Afatmesëm (PBA). Ndërsa buxheti i qeverisë zakonisht mbulon një vit të vetëm, PBA-ja parashikon planet dhe buxhetet për një periudhë më të gjatë, zakonisht tre deri në pesë vjet. Një PBA e nxit qeverinë të mendojë me afat të gjatë dhe të bëjë plane afatgjata. Ajo është me doli për legjislatorët dhe aktorët e shoqërisë civile që dëshirojnë të merren me avokati, meqenëse u jep atyre informacion të hershëm rreth planeve të ardhshme.

PBA-të shpesh prezantohen bashkë me ndonjë formë programi apo buxhetimi me bazë rezultatet. Qëllimi i buxhetimit programor është që të sigurojë një lidhje më të fortë midis politikës, planifikimit dhe buxhetimit. Synimi është që buxhetet të ndjekin politikën, dhe jo që politika të ndjekë buxhetin. PBA-të janë hartuar për të korigjuar situatën aktuale në shumë vende ku planifikimi dhe buxhetimi bëhen pavarësisht nga njëri tjetri. Planifikimi shpesh kufizohet me investimet apo shpenzimet kapitale. Shpenzimet periodike ndërkohë ndryshojnë shumë pak nga njëri vit në tjetrin, me përjashtim të përshtatjeve të inflacionit. Trajtimi i veçantë i shpenzimeve periodike dhe kapitale përkeqësohet nga fakti se kapitali, programet e zhvillimit apo të investimeve publike shpesh financohen nga donatorët dhe për ta ka udhëzime të ndryshme në lidhje me kontabilitetin dhe përdorimin e tij krahasuar me buxhetin periodik. Në një proces tipik të PBA-së, agjencitë qeveritare të linjës (ministritë, departamentet, dhe institucionet e tjera që sigurojnë shërbime) i përcaktojnë objektivat e tyre për një periudhë të caktuar. Pastaj ata planifikojnë veprimtaritë që nevojiten për arritjen e objektivave, përcaktojnë inputet e kërkuara, nxjerrin koston e veprimtarive dhe përcaktojnë synimet dhe treguesit e produkteve (realizimi). Secila prej agjencive duhet të përcaktojë përparësitë e objektivave dhe veprimtarive të saj në bazë të objektivave të përgjithshme shoqërore dhe ekonomike të qeverisë. Ministria

e Financave përgjigjet për shpenzimet e përgjithshme dhe për të siguruar që shpenzimet e përgjithshme të jenë në përputhje me “zarfin” ekzistues të burimeve. Lidhja e objektivave, veprimtarive, synimeve dhe treguesve është pjesë e aspektit të “efektivitetit” të PBA-ve.

Të kuptuarit e procesit të buxhetit

Procesi i buxhetit përbëhet nga një cikël procesesh. Hollësitë ndryshojnë nga njëri vend në tjetrin, por në shumicën e vendeve hapat kyçe të procesit të buxhetit janë:

- Përcaktimi i situatës makroekonomike
- Përgatitja e udhëzimeve dhe përcaktimi i taveve të shpenzimeve
- Përgatitja e propozimeve për shpenzime nga sektori i ministrisë
- Sigurimi i miratimit të ligjvënësve
- Monitorimi, vlerësimi dhe llogaridhënia

Përcaktimi i situatës makroekonomike – Përpara se qeveria të hartojë një buxhet, ajo duhet të dijë se cilat burime ka në dispozicion. Qeveria i projekton (vlerëson) burimet e saj të mundshme duke parë gjendjen makroekonomike, zakonisht me ndihmën e një modeli. Ky model makroekonomik sheh elemente të tilla si:

- Produkti i pritshëm i ekonomisë
- Defiçiti i buxhetit (ndryshimi midis shpenzimeve dhe të ardhurave)
- Bilanci i pagesave (që mat monedhën e huaj)
- Kursi i këmbimit (vlera e monedhës së huaj përkundrejt monedhës vendase)
- Mundësia e kredisë për hua

Sa para ka një qeveri varet nga zgjedhjet ekonomike dhe politike. Qeveria ka mundësi, për shembull, të rritë të ardhurat, duke shtuar taksat. Por ajo gjithashtu mund të zgjedhë se deri sa shpenzimet do t'i kalojnë të ardhurat për vitin e ardhshëm, pra, sa i madh do të jetë borxhi. Megjithatë, ka kufizime në lidhje me zgjedhjet e mundshme. Kjo ndodh veçanërisht në rastin e qeverive në vendet

22 BUXHETIMI I PËRGJIGJSHËM GJINOR NË SHQIPËRI

në zhvillim të cilat varen nga ndihma e huaj dhe nga huatë. Nga pikëpamja e të ardhurave, qeveritë kanë një farë kontrolli të nivelit të taksave. Megjithatë, edhe këtu, ata shqetësohen se taksat e larta për korporatat do t'i shkruajojnë investimet dhe se nivelet e larta të taksës personale do të largojnë votuesit e klasës së mesme. Kohët e fundit, agjenci shumëkombëshe si FMN dhe Banka Botërore, si edhe donatorë bilateralë kanë vënë kufij për deficitin dhe për tregues të tjerë makroekonomikë si një kusht për marrjen e huave, uljen e borxhit dhe forma të tjera të ndihmës. Kabineti ka përgjegjësinë e përgjithshme për të siguruar që buxheti të plotësojë objektivat ekonomike dhe shoqërore të vendit. Në plotësimin e kësaj përgjegjësie, ai përcakton përparësitë, nivelet e shpenzimeve dhe propozon caktimin e fondeve për sektorët e ndryshëm. Qeveria zakonisht i merr këto vendime mbështetur në këshillat e Ministrisë së Financave, Bankës Qendrore dhe Agjencisë së Planifikimit. Zakonisht, ajo përqendrohet në miratimin e ndryshimeve të mëdha në caktimin e burimeve, sidomos atyre të reja, apo në zgjerimin e programeve, apo atyre që duhen pakësuar. Ministria e Financave zakonisht merr vendime për ndryshime të tjera, më të vogla.

Përgatitja e udhëzimeve të buxhetit dhe përcaktimi i taveve të shpenzimeve

Ministria e Financave luan një rol qendror në procesin e buxhetit në shumicën e vendeve. Ajo ka përgjegjësinë kryesore për menaxhimin financiar dhe çështjet ekonomike dhe ka shumë ndikim në vendimmarrjen e kabinetit qeveritar. Marrëdhënia midis Ministrisë së Financave dhe ministrive të tjera të linjës mund të jetë marrëdhënie konfliktuale. Ndërsa ministritë e linjës duan sa më shumë para për vete që të jetë e mundur, Ministria e Financave duhet të baraspeshojë kërkesat e të gjitha ministrive dhe në të njëjtën kohë të kontrollojë edhe shpenzimet e përgjithshme.

Hapi i parë në procesin e buxhetit është të bëjë një vlerësim realist të të ardhurave në dispozicion. Në bazë të këtij vlerësimi, Ministria

e Financave apo agjencia planifikuese vendos për "tavanin" e përgjithshëm (maksimumin) e shpenzimeve tërësore, si edhe një tavan për secilën nga ministritë e linjës apo agjencitë që shpenzojnë para. Ministria e Financave pastaj shpërndan udhëzime për buxhetin për secilën ministri, duke përcaktuar tavanin e saj të shpenzimeve dhe si buxheti duhet të përgatitet. Ministritë e linjës pastaj përgatisin propozimet e tyre të buxhetit në bazë të këtyre udhëzimeve.

Tavanet e shpenzimeve duhet të mbështeten në objektivat e përgjithshme shoqërore dhe ekonomike të qeverisë. Për shembull, në rast se vendi ka një dokument për uljen e varfërisë, tavanet duhet të ndjekin përparësitë e saj. Megjithatë, Ministria e Financave duhet gjithashtu të marrë parasysh një numër angazhimesh buxhetore (Fozzard, 2000). Këto përfshijnë:

- Angazhimet ligjore të tilla si transfertat te pushteti lokal, ndihma ekonomike dhe pagesat e pensioneve, si dhe shpenzime për të ardhurat për fonde të tjera të posaçme
- Angazhime kontraktuale për të paguar punonjësit publikë
- Shërbimi i borxhit
- Kontrata për sigurimin e mallrave dhe shërbime të urdhëruara gjatë periudhave të buxheteve të mëparshme
- Marrëveshje me agjenci shumëpalëshe dhe dypalëshe për të paguar një përqindje të caktuar të projekteve dhe programeve të financuara nga jashtë.

Përgatitja e propozimeve për shpenzime nga ministritë e linjës

Hapi tjetër është që ministritë e linjës të hartojnë propozimet e tyre të detajuara për mënyrën se si ato do t'i shpenzojnë paratë që do t'iu caktohen në "tavanin" e tyre. Në shumicën e vendeve, ministritë e bëjnë këtë si një proces i brendshëm. Megjithatë, në pak vende qeveritë e kanë hapur procesin për të marrë mendimet e të tjerëve. Pasi ministritë të kenë paraqitur propozimet e tyre,

Ministria e Financave bën mbledhje të veçanta me secilën prej tyre për të negociuar. Sikundër në rastin e tavanit të përgjithshëm, propozimet e ministrive të linjës duhet të përputhen me objektivat e përgjithshme të vendit, si edhe me planet e veçanta të sektorëve të ndryshëm. Gjithsesi, shumë shpesh ministrinë paraqesin propozimet e tyre për shpenzime që mbështeten thjesht në buxhetin e vitit të mëparshëm, duke bërë ndoshta përshtatjet e inflacionit. Në raste të tjera, ato paraqesin propozime që janë shumë më të larta se tavanet, me shpresën se propozimet e larta do ta bindin Ministrinë e Financave për shkallën e kërkesës së tyre. Kur propozimet janë shumë mbi tavanin, diskutimet përqendrohen në ato vende ku shpenzimet mund të shkurtohen. E keqja me çdo vlerësim tejet të madh është se ka të ngjarë që të interpretohet si një shenjë se ministria e linjës nuk është serioze, apo nuk ka aftësitë për të bërë planifikimin e saj. Meqenëse Ministria e Financave zakonisht nuk e kupton një sektor po aq mirë sa edhe ministria vetë, ajo mund të shkurtojë programe që për ministrinë janë të rëndësishme. Shkurtime mund të ndodhin në këtë fazë edhe kur propozimet janë brenda kufijve të tavanëve. Kjo ndodh për shembull kur institucionet multilaterale e kanë bindur Ministrinë e Financave se vlerësimet e saj fillestare të të ardhurave ishin shumë të larta, ose se defiqiti i planifikuar prej saj ishte shumë i madh.

Sigurimi i miratimit të Parlamentit

Në shumicën e vendeve, shpenzimet e qeverisë dhe mbledhja e të ardhurave kërkojnë një farë miratimi ligjor. Kabineti i Ministrisë së Financave përgatit propozimet e buxhetit, por legjislatura – si përfaqësuese e popullit – zakonisht duhet t'i miratojë këto propozime përpara se ato të bëhen të zbatueshme ligjërisht. Funkcioni parësor i legjislaturës në procesin e buxhetit është që të miratojë projektligjin e buxhetit. Kjo i jep asaj mundësinë të shqyrtojë, diskutojë dhe të vendosë për pranueshmërinë e propozimeve të qeverisë. Megjithatë, shqyrtimi legjislativ mund të jetë i pamjaftueshëm për një numër arsyesh:

- Nuk ka kohë të mjaftueshme për shqyrtim dhe diskutime të buxhetit
- Informacioni i kërkuar për analizën e buxhetit mund të mungojë
- Ligjvënësit mund të mos kenë aftësinë, burimet apo vullnetin që të analizojnë buxhetin
- Të drejtat legjislative në lidhje me buxhetin mund të jenë të kufizuara
- Qeveria mund të ketë shumë ndikim tek vendimmarrja legjislative
- Një numër i kufizuar grupesh të caktuara të interesit mund të kenë shumë pushtet dhe kështu e pakësojnë mundësinë e ligjvënësve për t'u përqendruar te buxheti për realizmin e qëllimeve parësore të kombit.

Pas miratimit të ligjit të buxhetit, ligjvënësit janë përgjegjës edhe për kontrollin e zbatimit të buxhetit. Megjithatë, kontrolli dhe mbikëqyrja shpesh janë të kufizuara nga mundësia e gjetjes së informacionit dhe nga cilësia e informacionit të dhënë.

Roli i grupeve të ndryshme të interesit në procesin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor

Aktorët përgjegjës për buxhetimin e përgjigjshëm gjinor janë nëpunëset dhe nëpunësit civilë, ministret dhe ministrat, Ministri/Ministrja e Financave, punonjëset dhe punonjësit e Thesarit, bordet e drejtorëve, si dhe planifikuesit e planifikueset e programeve. Në nivel kombëtar, rajonal apo vendor arritja e barazisë gjinore garantohet vetëm atëherë kur në procesin e buxhetimit kemi përfshirë perspektivën gjinore. Nisma për buxhetimin e përgjigjshëm gjinor mund të vijë nga grupe të ndryshme të interesit, si brenda ashtu edhe jashtë sektorit shtetëror. Aktorët më të rëndësishëm të interesit në procesin e përfshirjes së aspektit gjinor në buxhete janë qeveria dhe parlamenti. Grupe të tjera të rëndësishme interesi që duhet të përfshihen në këtë proces janë: studiuesit, specialistët, organizatat ndërkombëtare dhe joqeveritare, sindikatat dhe

**Nismat e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor
“që janë iniciuar nga vetë qeveritë” në përgjithësi
kanë qenë më të efektshme në rastet kur procesin e
ka udhëhequr ministria e financave në bashkëpunim
me ministrinë (institucionin apo mekanizmin) që është
përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore.**

shoqatat e punëdhënësve. Rolet dhe përgjegjësitë e qeverisë dhe grupeve të tjera të interesit janë formuluar me hollësi nga Këshilli i Evropës (2005). Më poshtë përshkruhet roli tipik i tyre në procesin e përfshirjes së aspektit gjinor në buxhet.

Qeveria dhe **administrata publike** janë grupe kyçe interesi kur bëhet fjalë për integrimin dhe zbatimin e perspektivës gjinore në buxhetet publike. Qeveria është një mekanizëm kompleks që përbëhet nga kabineti/këshilli i ministrave dhe administrata publike në nivel ministrie, drejtorie dhe agjencish. Vendimet e qeverisë përgatiten dhe zbatohen nga një rrjet grupesh të ndryshme interesi, si nga ana e administratës shtetërore ashtu edhe nga institucionet publike. Suksesi i përfshirjes së aspektit gjinor në buxhet varet nga angazhimet politike dhe kapacitetet qeverisëse, si dhe nga rolet e përcaktuara qartë për palët e ndryshme të interesit të përfshira. Nismat e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor “që janë iniciuar nga vetë qeveritë” në përgjithësi kanë qenë më të efektshme në rastet kur procesin e ka udhëhequr ministria e financave në bashkëpunim me ministrinë (institucionin apo mekanizmin) që është përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore. Duke qenë se procesi i përfshirjes së aspektit gjinor në buxhet përfshin të gjitha fushat e politikave, ai ka

nevojë për ekspertizën, angazhimin dhe bashkëpunimin reciprok të nëpunësve civilë të nivelit të lartë, këshilltarëve dhe specialistëve të cilëve iu është ngarkuar detyra e përgatitjes së buxhetit, si dhe strukturave që janë përgjegjëse për barazinë gjinore. Këto palë interesi kanë rëndësi kyçe për suksesin e këtij procesi.

Ekspertiza e nevojshme lidhur me çështjet e barazisë gjinore duhet të sigurohet nga mekanizmat e barazisë gjinore të cilat sipas kontekstit kombëtar mund të organizohen si institucione shtetërore, si ministri ose drejtori të veçanta ose institucione promovuese me mandat në nivel kombëtar/qeverie. Roli i këtyre mekanizmave të barazisë gjinore është që të ofrojnë asistencë profesionale, formim dhe informim, të promovojnë dhe bashkërendojnë buxhetimin gjinor dhe të asistojnë në përgatitjen e buxhetit. Niveli i pjesëmarrjes së tyre varet nga bashkëpunimi me grupet e tjera të interesit, veçanërisht me ministrinë e financave. Administrata përgjegjëse për buxhetin nga të gjitha ministrinë e linjës, duhet të bashkëpunojë në mënyrë reciproke me specialistët e barazisë gjinore. Një bashkëpunim i tillë është sidomos i nevojshëm kur bëhet fjalë për zhvillimin e instrumenteve për zbatimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor duke qenë se kjo e tejkalon qasjen e përbashkët administrative, udhëzimet dhe listat e kontrollit.

Roli dhe përgjegjësitë e qeverisë kanë të bëjnë me: bashkërendimin ndërqeveritar dhe shkëmbimin e vazhdueshëm të informacionit midis drejtorive dhe pjesëmarrësve në procesin e buxhetimit gjinor, zhvillimin e koncepteve të përqendruara tek administrimi i buxhetit me ndjeshmëri gjinore, shpërndarjen e informacionit në mënyrë që të rritet ndërgjegjësimi për domosdoshmërinë e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor, zhvillimin e koncepteve për strukturat e trajnimit të drejtuesve, në veçanti drejtorive dhe shërbimeve; përgatitjen e pyetësorëve të standardizuar për të siguruar informacion ku të mbështeten vendimmarrësit e politikave dhe buxhetit, përgatitjen e udhëzimeve për përmirësimin e bazës së të dhënave sipas gjinisë duke përfshirë instrumentet analitike, projekt-konceptet e politikave, hartimin e masave të monitorimit vlerësimit dhe ekspertizës së veçantë profesionale. Qeveria ka një rol kyç sa i takon administrimit të procesit të buxhetimit gjinor dhe vendosjes së roleve që duhen luajtur nga aktorët e ndryshëm në proces.

Ministria e Financave luan një rol kyç në përfshirjen e aspektit gjinor në buxhetin kombëtar, duke qenë se ajo është përgjegjëse për bashkërendimin e aktiviteteve të përgjithshme në nivel qendror. Përgjegjësitë e saj kanë të bëjnë me procesin e buxhetimit në nivel kombëtar, zhvillimin e kuadrit buxhetor nga perspektiva gjinore (e kryer së bashku me institucionet dhe mekanizmat përgjegjëse për barazinë gjinore), marrjen e raporteve për përfshirjen e aspektit gjinor në buxhet nga ministritë përkatëse, përpilimin e raporteve vjetore të progresit për zbatueshmërinë e buxhetimit gjinor, përgatitjen e evidencave me ndjeshmëri gjinore për përfituesit e fondeve të buxhetit, analizën gjinore të efektshmërisë së shpenzimeve publike dhe faktorë të tjerë që duhen mbajtur në konsideratë në planifikimin e mëtejshëm dhe përdorimin e buxhetit.

Ministritë e linjës kanë përgjegjësinë për t'i paraqitur ministrisë së financave planet buxhetore, për realizimin e buxhetit në bazë

të politikave dhe përparësive sektoriale të tyre (duke mbajtur në konsideratë analizat e politikave sektoriale me ndjeshmëri gjinore), përgatitjen e planeve dhe buxheteve me ndjeshmëri gjinore për sektorët e tyre, përcaktimin dhe raportimin e treguesve të buxhetimit dhe përgatitjen e planeve të trajnimit për stafin e tyre për çështje të ndryshme të lidhura me përfshirjen e aspektit gjinor në politikë dhe buxhet. Ka dy grupe kryesorë aktorësh të përfshirë në përgatitjen e PBA-së në nivel të ministrive të linjës:

- Ekipi i Menaxhimit të Programit (EMP) dhe
- Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS).

Në thelb, Ekipi i Menaxhimit të Programit përbëhet nga specialistë të fushës buxhetore në fjalë dhe është përgjegjës për detyrat teknike të identifikimit të produkteve dhe veprimtarive të lidhura me programin. Grupi për Menaxhimin Strategjik është një grup i nivelit të lartë i përbërë nga ministra dhe zëvendësministra dhe është përgjegjës për dhënien e orientimeve, vendosjen e përparësive dhe dhënien e miratimit. Ekipi i Menaxhimit të Programit zhvillon një sërë mbledhjesh në kuadër të përgatitjes së PBA-së. Puna e kryer gjatë këtyre mbledhjeve lidhet, sipas nevojës, me Grupin për Menaxhimin Strategjik për orientim dhe miratim. Prania e pikave fokale të barazisë gjinore në nivel ministrie në mbledhjet e Ekipit të Menaxhimit të Programit është domosdoshmëri për të siguruar një integritet të perspektivës gjinore në programet buxhetore.

Ministria/Institucioni/mekanizmi të cilës i është ngarkuar detyra e barazisë gjinore ka përgjegjësinë për zbatimin e politikave kombëtare për barazinë gjinore, shanset e barabarta, fuqizimin e grave dhe eliminimin e diskriminimit kundër grave; propozimin e nismave për buxhetet me bazë gjinore, realizon bashkëpunimin me ministrinë e financave dhe me ministritë e tjera, mbikëqyr procesin e përfshirjes së aspektit gjinor në buxhet në nivel qendror, ofron asistencë dhe ekspertizë për të gjitha çështjet e lidhura me barazinë gjinore dhe sensibilizon nga pikëpamja gjinore të gjitha palët e interesit të përfshira në këtë proces.

Shoqëria civile dhe OJF-të. Shoqëria civile dhe analistët e pavarur luajnë një rol të rëndësishëm në presionin ndaj qeverisë për të iniciuar nisma të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor. Efekti i tyre mbetet i kufizuar nëse qeveria, si palë kyçe interesi, nuk merr rolin kryesues në zbatimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor. Shoqëria civile konsiston në specialistë, mbështetës, aktivistë dhe profesionistë që punojnë në partneritet me qeverinë dhe shpesh ofrojnë shtysën për iniciimin e nismave për buxhete të përgjigjshme gjinore. Në mbarë botën, përfshirja e aspektit gjinor në buxhet ka ardhur si rezultat i politikës dhe aktivizmit të feminizmit (Sharp & Broomhill, 2002). Grupet e shoqërisë civile kanë identifikuar buxhetimin e përgjigjshëm gjinor si një mjet praktik në procesin e integritimit gjinor në politikën makroekonomike. Nismat e suksesshme të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor, kanë ndodhur si rezultat i bashkëpunimit të ngushtë midis sektorëve joqeveritarë dhe qeveritarë. Organizatat joqeveritare/jofitimprurëse kanë një rol kyç në procesin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në punën studimore dhe justifikimin e mekanizmave analitike, instrumenteve dhe metodave të nevojshme për përdorimin e buxhetimit gjinor; ofrimin e trajnimit për nëpunësit civilë dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik. Sindikatat dhe shoqatat e punëdhënësve japin një kontribut të konsiderueshëm në zbatueshmërinë e nismave për buxhetimin gjinor, përmes organizimit dhe shprehjes së vullnetit kolektiv. Një rol të veçantë në këtë aspekt luhet nga sektorët dhe grupimet e grave pranë sindikatave, duke kontribuar në fuqizimin e grave nëpërmjet përmirësimit të statusit ekonomik dhe shoqëror të tyre si rrjedhojë e efekteve të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor.

Parlamenti. Përmes punës bindëse dhe lobimit kontribuon në forcimin e angazhimit të qeverisë në lidhje me buxhetimin e përgjigjshëm gjinor. Rolet dhe përgjegjësitë e deputetëve kryesisht lidhen me punën bindëse për procesin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor përmes komisioneve parlamentare, verifikimit të pranisë së aspekteve gjinore brenda buxhetit përpara miratimit të tij dhe

mbikëqyrjes së zbatimit të buxhetit. Por, siç paralajmëron Budlender dhe të tjerët (Budlender, Elson, Hewitt dhe Mukhopadhyay, 2002), roli i deputetëve varet nga pushteti politik që kanë në dorë në jetën e përgjithshme e politike në vend.

Organizatat dhe agjencitë ndërkombëtare. Agjencitë ndërkombëtare dhe dypalëshe që mbështetin nismat e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor luajnë një rol kyç kur bëhet fjalë për hartimin dhe miratimin e standardeve ndërkombëtare të barazisë gjinore, rezolutave të posaçme dhe udhëzimeve. Ato gjithashtu ndihmojnë qeveritë të formulojnë strategjitë dhe nismat e tyre në këtë fushë. Organizatat ndërkombëtare nxisin dhe financojnë punën kërkimore dhe analizat në këtë fushë, mbledhin shembujt e praktikës së mirë dhe ofrojnë asistencë teknike dhe mbështetje për nismat e qeverive për buxhetimin e përgjigjshëm gjinor.

Institucionet e pavarura, gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor. Në mënyrë të veçantë institucione të tilla si Avokati i Popullit apo Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi duhet të jenë tepër aktive në dhënien e informacionit në lidhje me pabarazitë dhe diskriminimin bazuar në çështjet që trajtojnë në praktikën e punës së përditshme, si dhe duhet të ndihmojnë në formulimin e strategjive dhe nismave për adresimin e tyre.

Studiuesit. Specialistët dhe studiuesit luajnë një rol të rëndësishëm sa i takon iniciimit, ndërgjegjësimit, zhvillimit, krahasimit dhe zbatimit të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor. Ata marrin pjesë në këtë proces si specialistë të pavarur apo si anëtarë të organizatave joqeveritare apo grupeve të grave. Kontributi i tyre është shumë i konsiderueshëm, duke qenë se buxhetimi i përgjigjshëm gjinor kërkon punë kërkimore dhe analiza të hollësishe për të cilat duhet ekspertizë dhe kohë, të cilat nëpunësit shtetërorë shpesh nuk i kanë. Kontributi i akademikëve është i domosdoshëm kur bëhet

fjalë për analizimin e efektit që kanë politikat, masat dhe strategjitë sa i takon barazisë gjinore. Roli i tyre është i rëndësishëm edhe në zhvillimin e metodikave dhe treguesve, trajnimin e nëpunësve civilë dhe vendimmarrësve, përgatitjen e treguesve dhe kontrollin e rezultateve të buxhetit.

Mediat. Mediat luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor. Por në të njëjtën kohë ato kufizohen nga niveli i lirisë dhe transparencës që gëzojnë në raport me influencën politike. Kërkesat për ndryshime në politikë dhe mënyrat e administrimit të buxhetit që i jepen qeverisë përmes mediave mund të kenë ndikim te politikanët dhe zyrtarët e nivelit të lartë, sidomos nëse shoqërohen me diskutime analitike. Në vende ku qeveria ushtron një shkallë të lartë influence mbi mediat ose kontroll të plotë mbi to, mediat nuk mund të veprojnë si një aleat dhe nuk pranojnë as edhe kritikën më të butë të veprimeve të qeverisë. Roli i mediave në promovimin e nismave të buxheteve të përgjigjshme gjinore varet edhe nga lloji dhe niveli i mediave. Komentet dhe analizat e mediave mbi tatimet, pensionet dhe programet e mbështetjes së familjeve mund të mos përfshihen në aspektet e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor, por mund të mbulojnë aspekte të rëndësishme të problemeve gjinore në shoqëri.

2.2. Ligji “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”

Shqipëria ka një kuadër ligjor të përditësuar sa i takon çështjeve buxhetore, në thelb të të cilit qëndron Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin 114/2012 dhe me ligjin 57/2016. I ashtuquajtur i ndryshe dhe ligji organik i buxhetit, ky ligj rregullon sistemin

buxhetor në Republikën e Shqipërisë, strukturën, parimet dhe bazat e procesit buxhetor, marrëdhëniet financiare ndërqeveritare dhe përgjegjësitë për zbatimin e legjislacionit buxhetor në tërësi. Ai zbatohet nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme (tërësia e njësitë të qeverisjes qendrore, vetëqeverisjes vendore dhe të fondeve special) në të gjitha fazat e procesit buxhetor, që do të thotë:

- përgatitjen, shqyrtimin dhe miratimin e buxhetit;
- zbatimin, ndjekjen dhe rishikimin e buxhetit;
- të drejtat dhe kufizimet për huamarrjen, garancitë, si dhe format e tjera, të rrjedhura prej tyre;
- kontrollin, kontabilitetin, raportimin, inspektimin dhe auditimin e buxhetit.

Në këtë ligji⁸ saktësohen dhe një sërë konceptesh të lidhura me programin buxhetor afatmesëm, menaxhimin financiar e kontrollin, të tilla si:

- **“Program buxhetor afatmesëm”** - parashtrimi për tre vjet i planeve të shpenzimeve të buxhetit, përmes lidhjes së drejtpërdrejtë të programeve me veprimtaritë, produktet, objektivat dhe qëllimet e politikës.
- **“Program buxhetor”** - një grup veprimtarish të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, që administrohen efektivisht dhe ndihmojnë së bashku në prodhimin e produkteve të identifikueshme dhe të matshme, të cilat ndihmojnë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në arritjen e objektivave dhe të qëllimeve të politikës buxhetore së tij.
- **“Qëllim i politikës së programit buxhetor”** - rezultati i dëshirueshëm dhe i matshëm, që arrihet në një periudhë afatgjatë nga veprimtaritë e njësitë të qeverisjes së përgjithshme.
- **“Objektiva të politikës së programit buxhetor”** - rezultatet e veçanta të matura saktësisht në kohë, sasi dhe kosto, të cilat realizohen në një periudhë afatshkurtër deri afatmesme dhe që përbëjnë hapa të ndërmjetëm drejt arritjes së qëllimit të politikës së programit buxhetor.

⁸ Neni 2, “Përkufizime”

28 BUXHETIMI I PËRGJIGJSHËM GJINOR NË SHQIPËRI

- **"Inpute"** - burimet financiare, njerëzore dhe fizike, të përdorura për kryerjen e veprimtarive, që nevojiten për ushtrimin e funksioneve të caktuara dhe që finalizohen me prodhimin e produkteve të caktuara.
- **"Veprimtari të programeve buxhetore"** - tërësia e veprimtarive, që kryhen në kuadër të një programi, për realizimin e një produkti.
- **"Produkte"** - mallrat dhe shërbimet e siguruar nga kryerja e veprimtarive buxhetore të programit buxhetor.
- **"Tavan i programit buxhetor afatmesëm"** - kufiri i sipërm i shpenzimeve, brenda të cilit njësitë e qeverisjes së përgjithshme përgatisin kërkesat buxhetore të këtij programi.
- **"Menaxhimi financiar dhe kontrolli"** - një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, nëpërmjet të cilave burimet financiare janë planifikuar, drejtuar dhe kontrolluar për të mundësuar dhe influencuar ofrimin me sukses dhe efektshmëri të shërbimeve publike.

Barazia Gjinore - e cila i referohet situatës ku burri dhe gruaja kanë mundësi dhe akses të barabartë në të drejta dhe përfitime të së njëjtës natyre, citohet tashmë si një ndër parimet e funksionimit të sistemit buxhetor (neni 4, pika e). Përfshirja e parimit të barazisë gjinore në Ligjin Organik për Buxhetin u mundëson të gjitha ministrive të linjës dhe institucioneve të pavarura të shqyrtojnë dhe të paraqesin qartë politikat e tyre gjinore, pa asnjë përjashtim. Përpos kësaj, mundësohet dhe një ndërgjegjësim më i madh i punonjësve të lartë të menaxhimit në ministrinë e linjës dhe institucionet buxhetore në trajtimin e efektshëm të çështjeve gjinore, që rrjedhimisht çon drejt fuqizimit të barazisë gjinore. Zbatimi me efektivitet i këtij parimi dhe i ligjit në tërësi, mundëson dhe krijimin e kushteve të nevojshme për monitorimin e politikave të ndjeshme gjinore gjatë zbatimit të buxhetit, si dhe për vlerësimin dhe auditimin e tij në përputhje me ciklin e menaxhimit financiar publik.

Disa nga organet kryesore përgjegjëse të cituara në këtë ligj së bashku me përgjegjësitë që mbartin janë:

- Kuvendi, me ligj të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes qendrore, transfertat e pakushtëzuara për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet e veçanta, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve të tyre, si dhe burimet e financimit të deficitit buxhetor.
- Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet e veçanta të tyre, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve që kanë, si dhe huamarrjen, për financimin e projekteve të investimeve.
- Këshilli i Ministrave miraton drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe, në bazë të tyre, i propozon Kuvendit ligjin e buxhetit vjetor. Këshilli i Ministrave vendos norma dhe standarde financiare për shpenzimet publike, të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme.
- Ministri i Financave është autoriteti përgjegjës për hartimin dhe miratimin e një sistemi rregullash, standardesh dhe procedurash, që sigurojnë administrimin ekonomik, eficient dhe efektiv të burimeve financiare publike.
- Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore propozon drejtimet kryesore të politikës së njësisë së qeverisjes vendore dhe projektbuxhetin në këshillin përkatës të njësisë së qeverisjes vendore.
- Sekretari i përgjithshëm i ministrisë përgjegjëse për financat është nëpunësi i parë autorizues për buxhetin e njësisë së qeverisjes qendrore, për fondet e veçanta të qeverisjes qendrore dhe transfertat e njësisë të qeverisjes vendore. Nëpunësi i parë autorizues përgjigjet te Ministri i Financave për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe kontrollin e brendshëm financiar publik, sipas ligjit të buxhetit vjetor dhe akteve nënligjore.

Në ligj parashikohet qartësisht edhe caktimi dhe funksionet e nëpunësit të njësisë së qeverisjes vendore si dhe të nëpunësit zbatues.

- Nëpunës autorizues, në njësitë e qeverisjes qendrore, është punonjësi i administratës publike i nivelit më të lartë të shërbimit civil. Për Ministrinë e Financave, nëpunësi i parë autorizues emëron një punonjës të nivelit të lartë të administratës publike si nëpunës autorizues. Në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, që nuk janë pjesë e pushtetit ekzekutiv, nëpunës autorizues është punonjësi i nivelit më të lartë menaxhues. Nëpunës autorizues në njësitë e qeverisjes vendore është kryetari i njësisë, ndërsa zëvendësi i tij është nëpunës autorizues i deleguar, nëse kryetari vendos ta delegojë këtë përgjegjësi. Nëpunësi autorizues i njësisë shpenzuese është titullari i kësaj njësie. Titullari i njësisë së qeverisjes së përgjithshme njofton nëpunësin e parë autorizues për caktimin e nëpunësit autorizues të njësisë së vet. Nëpunësi autorizues është përgjegjës për menaxhimin financiar në njësinë e qeverisjes së përgjithshme ku është caktuar, në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 4, të këtij ligji.

Në ligj parashikohet qartësisht edhe caktimi dhe funksionet e nëpunësit të njësisë së qeverisjes vendore si dhe të nëpunësit zbatues.

Procesi i përgatitjes, shqyrtimit dhe miratimit të buxhetit të shtetit ka të përcaktuara këto etapa kryesore dhe afate kohore:

- Ministri i Financave paraqet, për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave, raportin për vlerësimet dhe parashikimet

makroekonomike për:

- dy vitet përpara vitit buxhetor;
- vitin buxhetor;
- tre vitet e ardhshme buxhetore brenda muajit janar
- Bazuar në vlerësimet dhe parashikimet makroekonomike të miratuara, Ministri i Financave përgatit tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm dhe i dërgon për shqyrtim e miratim në Këshillin e Ministrave brenda muajit shkurt. Ministri i Financave, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave të vlerësimeve dhe parashikimeve makroekonomike e buxhetore, brenda muajit shkurt, miraton dhe dërgon për zbatim në njësitë e qeverisjes së përgjithshme edhe Udhëzimin për përgatitjen e buxhetit qendror
- Këshilli i Ministrave miraton vlerësimin dhe parashikimin makroekonomik dhe ia përcjell Kuvendit brenda datës 10 mars
- Këshilli i Ministrave, miraton me vendim, projektin e programit buxhetor afatmesëm dhe tavanet përfundimtare të shpenzimeve brenda muajit qershor
- Nëpunësi i parë autorizues, njofton çdo njësi të qeverisjes vendore dhe çdo njësi të fondeve speciale të qeverisjes vendore për transfertat nga njësitë e qeverisjes qendrore dhe pjesën e madhësinë e taksave kombëtare, të ndara në projektbuxhet brenda muajit korrik
- Pas miratimit, nga Këshilli i Ministrave, të tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm, Ministri i Financave, nxjerr: Udhëzimin plotësues për përgatitjen e

30 BUXHETIMI I PËRGJIGJSHËM GJINOR NË SHQIPËRI

buxhetit qendror dhe Udhëzimin plotësues për përgatitjen e buxhetit vendor brenda datës 10, të muajit korrik

- Nëpunësit autorizues të njësive të qeverisjes qendrore dhe të njësive të fondeve speciale të qeverisjes qendrore paraqesin te nëpunësi i parë autorizues kërkesat e rishikuara të programit buxhetor afatmesëm dhe kërkesat shtesë, me argumentet përkatëse brenda datës 1 shtator të çdo viti
- Këshilli i Ministrave miraton me vendim projektbuxhetin vjetor dhe programin buxhetor afatmesëm, të rishikuar brenda datës 15 tetor
- Nëpunësi i parë autorizues, njofton çdo njësi të qeverisjes vendore dhe çdo njësi të fondeve speciale të qeverisjes vendore për transfertat nga njësitë e qeverisjes qendrore dhe pjesën e madhësinë e taksave kombëtare, të ndara në projektbuxhet brenda 10 ditëve, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave të buxhetit vjetor dhe programit buxhetor afatmesëm, të rishikuar
- Kryeministri, në emër të Këshillit të Ministrave, i paraqet Kuvendit projektbuxhetin vjetor brenda datës 20 tetor
- Projektligji i buxhetit vjetor miratohet nga Kuvendi, brenda datës 15 dhjetor

Ndërsa në nivel vendor, njësitë e vetëqeverisjes vendore hartojnë dhe miratojnë buxhetin vendor dhe programin buxhetor afatmesëm. Procedurat dhe afatet e hartimit të programit buxhetor afatmesëm përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave. Për funksione dhe kompetenca që ndërthuren me ato të qeverisjes qendrore, organet e qeverisjes vendore bashkëpunojnë me ministrinë dhe institucionet buxhetore. Detajet dhe mënyra e bashkëpunimit përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe ministrit përgjegjës për çështjet vendore. Si rregull, brenda muajit nëntor të vitit buxhetor, kryetarët e njësive të qeverisjes vendore paraqesin për miratim buxhetet në këshillat e tyre.

Këshilli i qeverisjes vendore, brenda datës 25 dhjetor, miraton buxhetin vendor, në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të

transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor. Buxhetet e njësive të qeverisjes vendore publikohen në Buletinin e Njoftimeve Publike përkatës 15 ditë pas miratimit nga këshillat e njësive përkatëse.

2.3. Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”

Miratimi i Ligjit Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ka krijuar mundësitë për përfshirjen e efektshme të BPGJ-së në të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit financiar vendor (programimi i buxhetit vjetor dhe afatmesëm, monitorimi dhe raportimi, vlerësimi dhe auditimi) nga njësitë e qeverisjes vendore. Kështu, që në qëllimin e ligjit (neni 2, pika 8) theksohet që vetë ligji ka si qëllim të sigurojë që në krijimin dhe shpërndarjen e burimeve financiare vendore të njësive të vetëqeverisjes vendore përshpejtohet dhe realizohet barazia gjinore.

Po kështu, në nenin 36 të ligjit ku trajtohet dhe Programi Buxhetor Afatmesëm Vendor, në pikën c të tij theksohet se të paktën një nga objektivat e politikave të programeve duhet të adresojë problematika të pabarazisë gjinore ose respektimin e plotë të barazisë gjinore, duke identifikuar qartazi produktet dhe treguesit e tjerë të matshëm me bazë gjinore.

2.4. Udhëzimet për aplikimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor

Udhëzimi nr.7 datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” shërben si udhëzim i përhershëm për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm.

Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i: a. metodologjisë së buxhetimit mbi bazë programesh dhe performance; b. rregullave, procedurave, dhe afateve që duhet të ndiqen në procesin e hartimit të programit buxhetor afatmesëm nga njësitë e qeverisjes qendrore dhe njësitë e fondeve special. Në udhëzues përcaktohen qartësisht përgjegjësitë e aktorëve kryesorë në procesin e hartimit të programit buxhetor afatmesëm. Në lidhje me adresimin e çështjeve gjinore dhe buxhetimin e përgjigjshëm gjinor, evidentohen këto parashikime:

- Titullari i njësisë së qeverisjes qendrore siguron që dokumenti i programit buxhetor afatmesëm krahas parimeve të tjera të sistemit buxhetor, respekton dhe parimin e barazisë gjinore.
- Nëpunësi Autorizues në rolin e Koordinatorit të Grupit të Menaxhimit Strategjik, mundëson:
 - Sigurimin që për secilin program buxhetor në përgjegjësinë e tyre minimalisht të përfshijë një qëllim të politikës që adreson respektimin e plotë të barazisë gjinore, ose promovon barazinë gjinore në fushën/sectorin përkatës.
 - Aty ku gjykohet e aplikueshme, në bashkërendim me Ministrinë përgjegjëse për financat, sigurohet që programet buxhetore të evidentojnë objektiva konkretë me bazë gjinore të shoqëruara me tregues të përshtatshëm dhe të matshëm performance, ku do të synohet që të identifikohen një ose disa produkte me kostot përkatëse që do të kontribuojnë në realizimin e tyre.
 - Masat e nevojshme për të mundësuar evidentimin, mbledhjen dhe administrimin e të dhënave të disagreguara sipas gjinisë të cilat gjykohen si të domosdoshme për të planifikuar qëllimet dhe objektivat me bazë gjinore, si dhe për të matur progresin e arritur në këtë kontekst.
- Drejtuesi i Ekipit të Menaxhimit të Programit, është përgjegjës për përcaktimin për programin buxhetor në përgjegjësinë e tyre minimalisht të një objektivi të politikës që adreson respektimin e plotë të barazisë gjinore ose promovon barazinë gjinore

në fushën/sectorin përkatës. Këto objektiva duhet të jenë të shoqëruara me tregues të përshtatshëm dhe të matshëm performance, ku do të synohet që të identifikohet një ose disa produkte me kostot përkatëse që do të kontribuojnë në realizimin e tyre.

Shtojca 5 e udhëzuesit përmban informacion mbi përgatitjen e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor.

Në Udhëzimin nr. 7/1, datë 28.02.2018 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2019 – 2021", pika 8 i dedikohet sërish buxhetimit të përgjigjshëm gjinor dhe përfshirjes së shoqërisë civile në përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2019-2021. Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 465, datë 18.07.2012 "Për integrimin gjinor në Programin Buxhetor Afatmesëm" dhe të udhëzimit të përbashkët nr. 21, datë 21.06.2013 "Për përcaktimin e procedurave për integrimin gjinor në programin buxhetor afatmesëm", të gjitha ministritë e linjës brenda një ose dy programeve buxhetore përkatëse duhet të përcaktojnë objektiva të përshtatshëm e të matshëm, të detajuara në produkte/aktivitete/kosto për arritjen e barazisë gjinore.

I njëjti paragraf sa më sipër citohet dhe në pikën 6 të Udhëzimit plotësues nr. 7/2, datë 28.02.2018 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2019 – 2021"

2.5. Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008 **"Për barazinë gjinore në shoqëri"**

Synimi i këtij ligji është: a) të sigurojë mbrojtje efikase nga diskriminimi për shkak të gjinisë; b) të përcaktojë masa për garantimin e mundësive të barabarta ndërmjet grave e burrave, për të eliminuar diskriminimin me bazë gjinore; c) të përcaktojë

përgjegjësitë e autoriteteve shtetërore në të gjitha nivelet, për të hartuar dhe zbatuar aktet normative, si dhe politikat që mbështesin barazinë gjinore. Ligji për barazi gjinore kërkon që integrimi gjinor të jetë strategjia për arritjen e barazisë gjinore në shoqëri, nëpërmjet përfshirjes së perspektivës së secilës nga gjinitë në të gjitha proceset ligjvënëse, politikëbërëse, planifikuese, zbatuese e monitoruese. Ligji trajton edhe diskriminimin e ngacmimin dhe parashikon masa të veçanta të përkohshme për të garantuar të paktën 30% pjesëmarrje të gjinisë më pak të përfaqësuar në postet politike dhe vendim-marrëse publike. Ligji trajton barazinë gjinore dhe mbrojtjen nga diskriminimi në sektorët e arsimit, punësimit dhe mediave, dhe përmend shprehimisht nevojën e vlerësimit të punës së papaguar. Gjithashtu, ligji për barazinë gjinore parashikon mbledhjen e detyrueshme të të dhënave të ndara sipas seksit dhe statistikave gjinore, nga të gjitha organet shtetërore dhe parashikon ngritjen e strukturave dhe mekanizmave institucionalë për çuarjen përpara të barazisë gjinore.

Efektet e zbatimit të këtij ligji:

- Ngritja dhe fuqizimi i mekanizmave të barazisë gjinore⁹;
- Marrja e masave të posaçme lidhur me zbatimin e kuotës prej 30% në vendimmarrjen politike dhe publike;
- Rritja e ndërgjegjësimit të institucioneve dhe publikut për të drejtat e grave dhe çështjet e barazisë gjinore;
- Mbledhja e të dhënave gjinore sipas indikatorëve gjinorë¹⁰;
- Rishikimi i legjisllacionit në përgjithësi nga këndvështrimi gjinor;
- Avancimi në çështjet e buxhetimit gjinor¹¹.

9. Të tilla si: Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore (KKBGJ); ngritja dhe funksionimi i Rrjetit të Nënpusëve Gjinorë në ministrinë dhe bashkitë e vendit; ngritja e mekanizmit për barazinë gjinore, etj.

10. Të përcaktuar në Udhëzimin e "Treguesve të Harmonizuar mbi Barazinë Gjinore dhe Statusin e Grave në Shqipëri". http://www.un.org.al/editor-files/file/Harmonized_Indicators_ENGLISH.pdf

11. Nëpërmjet miratimit të VKM Nr. 465 datë 16.7.2012 "Për integrimin gjinor në programin buxhetor afatmesëm". Sipas këtij Vendimi të gjitha institucionet qendrore duke filluar nga viti 2013, planifikojnë në buxhetet e tyre objektiva të matshme për barazinë gjinore.

<http://www.unifem.sk/index.cfm?Module=articles&Page=ArticleShow&ArticleID=216>

2.6. Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike 2014 - 2020

Vizioni i strategjisë së reformës të menaxhimit të financave publike është garantimi i një sistemi të financave publike që nxit transparencën, përgjegjshmërinë, disiplinën fiskale dhe efikasitetin në menaxhimin dhe përdorimin e burimeve publike për ofrimin e shërbimeve të përmirësuara dhe zhvillimin ekonomik. Objektivi i përgjithshëm i strategjisë së reformës të MFP-së është që të arrijë një buxhet më të mirëbalancuar dhe të qëndrueshëm me një raport të ulur të borxhit publik nëpërmjet konsolidimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe proceseve të auditimit, dhe ku ekzekutimi i buxhetit është i lidhur siç duhet me politikat e Qeverisë.

Qëllimi i dokumentit të strategjisë të MFP-së është i trefishtë:

- Të identifikojë dhe adresojë sfidat me të cilat përballet menaxhimi financiar publik, dhe të sugjerojë reformat e nevojshme për të mbështetur zhvillimin e vazhdueshëm të qëndrueshëm dhe zhvillimin e ekonomisë kombëtare;
- Të nxisë koherencën e politikave, të caktojë prioritetet dhe delegojë përgjegjësi për realizimin e reformës së menaxhimit financiar publik;
- Të bëjë më transparente për Parlamentin, sektorin financiar, komunitetin e biznesit, partnerët ndërkombëtarë dhe publikun e gjerë, politikat e ndjekura dhe përpjekjet e bëra nga Qeveria për forcimin e MFP-së në vend.

Ndër të tjera, në këtë strategji theksohet rëndësia e zbatimit dhe menaxhimit efektivisht të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor si dhe monitorimi dhe raportimi i objektivave dhe rezultateve mbi bazë

2.7. Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2016-2020

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2016-2020, e treta e këtij lloji në Shqipëri, mbështetet në objektivat e programit të Qeverisë së Shqipërisë për barazinë gjinore dhe luftën kundër dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, kuadrin ligjor kombëtar, si dhe detyrimet ndërkombëtare që rrjedhin nga konventat dhe marrëveshjet e ratifikuara në këtë fushë, duke i kushtuar kujdes të veçantë sigurimit të përputhshmërisë me politikat e Bashkimit Evropian në kuadër të procesit të integritimit. Qëllimet strategjike, objektivat e veçanta dhe veprimet e propozuara bazohen gjithashtu edhe në rekomandimet e evidentuara në "Raport Vlerësimin: Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje dhe Planit të saj të Veprimit 2011-2015. Në Objektivin 4.3 të kësaj strategjie theksohet aplikimi i buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në zbatim të legjislacionit në fuqi, si dhe i planifikimit të ndjeshëm gjinor në të gjitha nivelet, në politikëbërje e vendimmarrje. Rezultati i pritshëm në lidhje me këtë objektiv synon që deri në fund të vitit 2020, buxhetimi i përgjigjshëm gjinor si dhe planifikimet e ndjeshme gjinore në politikëbërje e vendimmarrje, të jenë të aplikuara në të gjitha nivelet e qeverisjes. Numri i ministrive dhe institucioneve qendrore që zbatojnë buxhetimin e përgjigjshëm gjinor është një nga treguesit e parashikuar në matjen e zbatueshmërisë së kësaj strategjie.

2.8. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015 - 2020

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) përfaqëson dokumentin themelor strategjik që kombinon axhendën e integritimit në Bashkimin Evropian me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik

e shoqëror të vendit, përfshirë edhe ndërlidhjen me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. SKZHI II është dokumenti që paraqet vizionin për zhvillimin e demokracisë, zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të vendit gjatë periudhës 2015-2020, duke ravijëzuar aspiratat për integrim në Bashkimin Evropian. SKZHI 2015-2020 shpjegon se si ky vizion do të arrihet përmes politikave dhe përparësive që synojnë:

- Transformimin e Shqipërisë në një vend të denjë, për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian,
- arritjen e standardeve që u shërbejnë qytetarëve, rritjes së mirëqenies dhe sigurimit të mbrojtjeve të të drejtave të tyre, dhe
- ndërtimin e politikave që rrisin konkurrueshmërinë dhe rritjen ekonomike të vendit, krahasuar me vendet e rajonit dhe më tej.

Fuqizimi i kapaciteteve të përgjithshme të ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera qeveritare; për sa i takon analizës së politikave gjinore, planifikimit, manaxhimit të të dhënave, raportimit dhe monitorimit, me synim forcimin e barazisë ndërmjet grave dhe burrave, është një prej objektivave strategjikë të theksuar në këtë strategji bazë.



KAPITULLI 3

ANALIZA GJINORE

3.1. Çfarë është analiza gjinore

Analiza gjinore është pikënisja e trajtimit të përmasave gjinore të secilës prej çështjeve apo ndërhyrje për të kanalizuar përkatësinë gjinore. Analiza gjinore përcaktohet në mënyra të ndryshme në kontekste të ndryshme. Në nivelin e saj më bazë, ajo interpreton të dhëna për një situatë të caktuar apo të mundshme, nga këndvështrimi gjinor.

E thënë ndryshe, analiza gjinore është:

- Një përmasë themelore e analizës së politikave;
- Një identifikim i veçantë i mënyrës se si politikat publike ndikojnë burrat edhe gratë në mënyra të ndryshme;
- Një demonstrim i faktit se politikat dhe zbatimin e tyre, nuk mund të jenë neutrale ndaj perspektivës gjinore në shoqëritë e gjinizuara.

Analiza gjinore është një nënpjesë e një analize social-ekonomike.

Qëllimi i kësaj analize mund të jetë:

- së pari, ta nxjerrë në sipërfaqe faktin se marrëdhëniet gjinore kanë mundësi të ndikojnë në zgjidhjen e problemit, (dëshmim vendimmarrës mund të kenë nevojë akoma të shtyhen të besojnë këtë gjë),
- së dyti, të tregojë në mënyrë konkrete dhe të veçanta se çfarë

impakti mund të kenë (marrëdhëniet gjinore), si dhe të ofrojnë alternativë të mundshme veprimi.

Në fakt, në disa raste, çështjet gjinore mund të jenë domethënëse për një politikë të caktuar dhe mund të luajnë një rol të rëndësishëm në politikën dhe në zbatimin e saj. Si rrjedhojë, analiza gjinore i kushton vëmendje të posaçme dallimeve në rolet gjinore, në veprimtaritë, nevojat dhe mundësitë që ekzistojnë për burrat dhe gratë.

Objektivi i një analize të caktuar është të përcaktojë qartë këto dallime që shpesh nuk merren parasysh. Analiza bëhet në shumë nivele të ndryshme. Ajo mund të jetë një rishikim që kryhet nga tavolina e punës (desk review) kur planifikohet një projekt/ndërhyrje, ose mund të jetë një projekt kërkimor që mund të kryhet me kontratë me specialistë të jashtëm. Megjithatë, në çdo nivel, analiza gjinore ka një qëllim të përbashkët: të sigurojë informacion sasior dhe cilësor dhe të dhëna të cilat bëjnë të mundur një vendimmarrje të informuar për të mirën si të burrave, edhe të grave.

Analiza gjinore ndonjëherë quhet edhe:

- Analizë e ndjeshme ndaj përkatësisë gjinore: Ky term na kujton se duhet të jemi të ndjeshëm ndaj dallimeve me bazë gjinore të cilat nuk janë gjithnjë të dukshme. Duhet të kërkojmë informata të veçanta që këto dallime reale dhe të mundshme t'i bëjmë të dukshme në sytë e hartuesve të politikave.

- Analizë me bazë gjinore: Ky term thekson se ne jemi duke kërkuar pikërisht ato dallime që mbështeten te përkatësia gjinore.
- Analizë e ndërgjegjësuar për çështjet gjinore: Ky term na kujton se ndonëse shpesh ekzistojnë dallimet gjinore, studimet dhe analizat tradicionale nuk na bëjnë gjithnjë të vetëdijshëm për këto dallime. Na duhet një këndvështrim i posaçëm gjinor për të krijuar këtë vetëdije.

Secili prej këtyre termave thekson një aspekt apo objektiv të ndryshëm të analizës gjinore, por shpesh ata përdoren në vend të njeri tjetrit. Mbani mend, emri nuk është gjëja më e rëndësishme, ne duhet të përqendrohemi tek parimi i përgjithshëm të cilit i referohen të gjitha këto koncepte. Pavarësisht si e quajmë, analiza gjinore gjithnjë e interpreton informacionin nga një këndvështrim gjinor me qëllim nxjerrjen në pah të ngjashmërive dhe dallimeve midis burrave dhe grave. Si rrjedhojë, ajo e përdor këtë informacion për të marrë vendime më të mira për politikën dhe projektet. Në këtë mënyrë, siguron bazën e nevojshme të informacioneve për përfshirjen e këndvështrimit gjinor.

3.2. Komponentët bazë të analizës gjinore

Çdo lloj analize gjinore përbëhet nga tre komponentë të nevojshëm, që përshkruhen më me hollësi më poshtë:



1. Të dhëna të ndara sipas seksit

Këto fakte iu referohen të dhënave (statistikave, rezultateve të intervistave dhe informacioneve të tjera bazë) që bëjnë dallim të qartë midis të dhënave për gratë dhe të dhënave për burrat. Kini parasysh dallimin e mëposhtëm midis të dhënave të pandara dhe të dhënave të ndara sipas seksit:

- **Të dhëna të pandara sipas seksit:** 134 banorë të një Komunitetit X morën pjesë në një mbledhje për sistemet e reja të menaxhimit ujit në komunitetin e tyre. Në këtë Komunitet banojnë gjithsej 850 të rritur.
- **Të dhëna të ndara sipas seksit:** 134 banorë të një Komuniteti X morën pjesë në një mbledhje për sistemin e ri të menaxhimit ujit në komunitetin e tyre. 100 ishin burra dhe 34 gra. Në këtë kompleks banojnë gjithsej 850 banorë, nga të cilët ka një numër pothuaj të barabartë burrash dhe grash.

2. Analiza

Analiza i referohet interpretimit të këtyre të dhënave duke bërë pyetjen, "Çfarë do të thotë një informacion i tillë?" Për shembull, këtu më poshtë jepet një interpretim bazë i të dhënave të mësipërme: Analiza. Afërsisht një në pesë banorë mori pjesë në mbledhje, e cila u vlerësua si një pjesëmarrje relativisht e mirë. Pothuaj tre herë më shumë burra se gra morën pjesë në mbledhje.

3. Këndvështrimi gjinor

Ndërsa analiza e mësipërme vë në dukje dallimin midis burrave dhe grave, prapë ajo nuk analizon shkaqet apo pasojat e këtij dallimi. Integrimi gjinor do të thotë se interpretimi i të dhënave do të bëhet sipas teorive të njohura sociologjike (apo të tjera) për marrëdhëniet midis burrave dhe grave. Një integrim i tillë është me shumë rëndësi me qëllim që analiza të përdoret për hartimin e politikave dhe vendimmarrje më të mirë. Kini parasysh dallimet midis këtyre dy interpretimeve të mundshme të të dhënave të mësipërme:

Mungesa e këndvështrimit gjinor - Pjesëmarrja e grave në mbledhje ishte e pakët për shkak se:

- Gratë nuk ishin të interesuara për subjektin (menaxhimi i sistemit të ujit);
- Gratë nuk kanë njohuri për trajtimin e subjektit (menaxhimi i sistemit të ujit);
- Burrat janë vendimmarrës dhe udhëheqës më të mirë se gratë për çështje të tilla;
- Pjesëmarrja e pakët e grave në mbledhje nuk do të ketë ndonjë pasojë negative, sepse pavarësisht nga kjo, ato do të përfitojnë një lloj nga sistemi i ri;

Interpretimi nën këndvështrimin gjinor - Për shkak se gratë janë kryesisht përgjegjëse për detyra që kanë të bëjnë me administrimin e ujit, pjesëmarrja e tyre e pakët duhet të vijë nga faktorë të tjerë:

- A është bërë mbledhja në një kohë kur gratë kanë mundësi të marrin pjesë në të?
- A janë informuar gratë për mbledhjen?
- A lihen jashtë sistematikisht gratë nga proceset e vendimmarrjes politike?

Për shkak se gratë janë menaxheret kryesore të mbeturinave dhe ujit në shtëpi, pjesëmarrja e tyre në mbledhje ka të ngjarë të rezultojë në gjetjen e zgjidhjeve më pak të efektshme dhe të qëndrueshme.

Pra, analiza gjinore kërkon tre komponentë (të dhëna të ndara sipas seksit, analizë, dhe këndvështrim gjinor) për të mundur të na japë një bazë të besueshme informacioni për përfshirjen e këndvështrimit gjinor.

Teoritë gjinore themelore të domosdoshme për t'u njohur me qëllim që të përdorim sa më drejt analizën gjinore.

Sikurse u përmend më sipër, komponenti i tretë i çdo lloj analize

gjinore është integrimi gjinor në interpretimin e të dhënave. Kjo do të thotë se analiza duhet të jetë posaçërisht e informuar nga teori të pranuar për rolet gjinore, marrëdhëniet dhe barazinë. Me fjalë të tjera, analiza duhet të mbështetet në konkluzione të provuara të studimeve sociologjike për rrënjët e pabarazisë midis burrave dhe grave dhe për mënyrën se si mund të kapërcehen ato.

Politikat e veçanta **për gratë** janë ato politika/masa/ndërrhyrje që janë ekskluzivisht të hartuar për gratë. Historikisht të tilla qëndrime janë kritikuar shumë, meqenëse nevojat e grave analizoheshin si të ndara nga nevojat e gjithë shoqërisë. Sidoqoftë, një analizë e plotë e marrëdhënieve gjinore mund të tregojë nevojën e ndërhyrjeve të veçanta tek gratë me qëllim që të kompensohen pabarazitë e kaluara. Një qëndrim plotësisht i integruar kërkon edhe veprimtari të veçanta për gratë.

Politika, masa dhe veprime që përfshijnë komponentin grua.

Këto sigurojnë aktivitete dhe burime për gratë: në përgjithësi të formuluar si një shtesë pas planifikimit të politikës. Një qëndrim i tillë zakonisht bazohet në qëndrimin se nevojat e grave janë po aq të rëndësishme sa edhe nevojat e burrave dhe mund të plotësohen përmes veprimtarive të njëjta.

Politikat me komponentin grua të integruar. Këto përfshijnë

gratë në përqindje të barabartë me burrat në të gjitha veprimtaritë e projektit. Këto lloj ndërhyrjesh janë një hap më përpara se sa ato me komponentin grua të përfshirë. Situata e grave dhe burrave në mënyrë tipike analizohet në një marrëdhënie, por ndërhyrjet janë bazuar në hipotezën që çështjet e barazisë gjinore mund të përfshihen në qëndrimin për zhvillimin, i cili pasqyron paragjykimet gjinore të shoqërisë si një e tërë.

Politikat barazinë gjinore të integruar. Janë ato në të cilat ekziston ndërgjegjësimi dhe përkushtimi ndaj problemeve të

38 BUXHETIMI I PËRGJIGJSHËM GJINOR NË SHQIPËRI

grave dhe përparësitë që depërtojnë në të gjitha proceset dhe përcaktojnë axhendat e zhvillimit. Në këto politika ka një përpjekje të ndërgjegjshme për të eliminuar paragjykimet dhe stereotipet gjinore nga veprimtaritë e planifikuara. Të gjitha proceset vendimmarrëse pasqyrojnë politikat sociale që janë plotësisht "të gjinizuara". Analiza gjinore përqendrohet në marrëdhëniet shoqërore e sidomos në marrëdhëniet e fuqisë përmes të cilave paragjykimet dhe stereotipet gjinore mbahen dhe ruhen.

Një analizë gjinore duhet të sigurojë gjerësisht këto tipe informacioni:

- **Ndërgjegjësim gjinor:** në përgjithësi cila është situata për gratë dhe burrat në kontekstin që po analizohet?
- **Informacion në drejtim të punës:** duke marrë në konsideratë aktivitetet prodhuese dhe veprimtaritë riprodhuese shoqërore si dhe ndikimet e tyre për produktivitetin dhe qëndrueshmërinë ekonomike të kontekstit që po merret në analizë.
- **Prioritete e grave:** faktorët pengues dhe mbështetës - Si mund të zbatohet më mirë ky informacion në zhvillimin e problemit që adresohet, si edhe për arritje specifike të veçanta? A do të jetë e dobishme të mbështeten faktorët mbështetës ose të minimizohen faktorët pengues?
- **Nevojat praktike dhe Interesat strategjike.** A do të jetë më e përshtatshme në rrethanat e dhëna të adresohen nevojat e grave (dhe të burrave); (bëhet fjalë për nevojat praktike), apo të përdoret një qëndrim apo model transformues, si dhe të adresohen shkaqet e situatës së tyre, me qëllim që t'ju përgjigjen interesave të tyre strategjike dhe pse? Si do të ndikojnë këto qëndrime në përfundimet e projektit si dhe në situatën e grave dhe të burrave që po analizohen? Si do të ndikojnë ato në kontekstin e përgjithshëm shoqëror?:
 - Analiza gjinore na jep bazën e nevojshme të informacionit për përfshirjen e këndvështrimit gjinor.
 - Me qëllim që t'i shërbehët më mirë procesit të integritetit gjinor,

analiza gjinore kërkon të dhëna apo informacione të ndara sipas seksit dhe analiza kompetente të këtij informacioni nga këndvështrimi gjinor.

- Analiza nga një këndvështrim gjinor duhet të mbështetet në teoritë e duhura të pranuar për marrëdhëniet gjinore.
- Së fundi, analiza duhet të përfshijë përfundimet e duhura në lidhje me shkaqet dhe pasojat e pabarazive gjinore që nxjerr në pah. Përshkrimi i gjendjes është i rëndësishëm, por analiza e pasojave të këtij përshkrimi është kyç për një analizë të suksesshme gjinore.

Për shkak se analiza gjinore mund të përdoret në shumë mënyra të ndryshme, është po aq e rëndësishme që të jemi në gjendje të përcaktojmë se cila lloj analize gjinore do të na nevojitet për çdo situatë. Në rast se **informacioni** dhe **analiza** nuk gjenden me lehtësi, ne duhet të jemi në gjendje të mësojmë se si mund t'i prodhojmë ato.

Në këtë moment na vijnë në ndihmë një sërë pyetjesh të rëndësishme, disa prej të cilave renditen më poshtë:

- Kur duhet përdorur analizën gjinore?
- Cilat janë çështjet e studimit?
- Kush duhet ta bëjë analizën gjinore?
- Cila metodologji e analizës gjinore duhet përdorur?
- Çfarë lloj rezultatesh apo arritjesh duam të sigurohen nga analiza gjinore? Si mund të arrihen këto rezultate?
- Si duhet të porositet studimi për analizën gjinore?
- Si mund të integrohet analiza gjinore në veprimtari të tjera kërkimore?

Informacioni që nxirret nga përgjigjet e këtyre pyetjeve, përfaqëson në fakt në vetvete fazat e ndryshme që duhet të mbahen parasysht gjatë planifikimit të analizës gjinore. Duke shqyrtuar rolin dhe opsionet gjatë gjithë hapave të mësipërme, mund të sigurohemi që

do të marrim të gjithë informacionin që na duhet për të trajtuar me efektivitet përmaset gjinore të politikës apo ndërhyrjes.

3.3. Kur duhet përdorur analiza gjinore?

Analiza gjinore, në format e saj të ndryshme, mund të përdoret gjatë gjithë projektit apo ciklit të politikave. Në formën e saj më të zakonshme, ky cikël mund të ndahet në tre faza:

FAZA 1. Hartimi dhe zhvillimi i politikave

Këtu, analiza gjinore është kryesisht një mjet planifikimi. Ajo ju ndihmon të shihni situatën ekzistuese dhe ta përdorni informacionin për të marrë vendime për hartimin e ndërhyrjes që keni ndërmend të ndërmerrni (pra, objektivat, qëllimet dhe grupin që synoni të arrini dhe veprimet e planifikuara).

Disa pyetje që analiza gjinore kërkon t'iu përgjigjet gjatë kësaj faze janë:

- Cila është situata aktuale e burrave dhe grave në sektorin ku keni planifikuar ndërhyrjen?
- A do të kontribuojë projekti/politika e propozuar në pabarazitë që ekzistojnë në gjendjen e burrave dhe grave? T PRIVAT ARSIMI
- A i tejkalon apo sfidon projekti/politika e propozuar pabarazitë që ekzistojnë në gjendjen e burrave dhe grave?
- A i lufton, ose sfidon, projekti apo ndryshimi i politikave që propozohet, perceptimin apo stereotipet për burrat dhe gratë dhe rolet e tyre, në ndonjë farë mënyre?
- Cilat opsione duhen marrë në konsideratë për të forcuar këndvështrimin gjinor?

FAZA 2. Monitorimi i një politike.

Analiza gjinore mund të përdoret për të ndihmuar në monitorimin e përparimit të bërë nga këndvështrimi gjinor edhe

gjatë zbatimit të një politike. Disa pyetje që duhet t'i bëni janë:

- A janë burrat dhe gratë njëllor të përfshira në procesin e zbatimit?
- A lidhet përparimi drejt një objekti konkret me burrat apo gratë që synohen?
- A ka dalë ndonjë çështje gjinore, e cila nuk ishte identifikuar më parë nga projekti apo politika në fazën e hartimit? Si mund të trajtohet ajo?

FAZA 3. Vlerësimi i një politike.

Në rast se analiza gjinore është bërë në fazën e planifikimit, atëherë përdorimi i analizës gjinore në fazën e vlerësimit do t'iu japë mundësi të shihni shkallën në të cilën janë realizuar synimet dhe qëllimet tuaja. Në rast se një analizë gjinore nuk është marrë në konsideratë gjatë fazës së planifikimit, përfshirja e saj në këtë fazë prapë do të shërbejë si një mjet i rëndësishëm mësimi për të parë se sa mirë i ka trajtuar një politikë nevojat, si të burrave edhe të grave. Ky informacion pastaj mund të përdoret gjatë ndërhyrjeve apo politikave të ardhshme. Disa pyetje që mund të kihen në konsideratë gjatë kësaj faze janë:

- A e ndryshoi situatën e burrave dhe të grave politika? Në rast se po, për mirë apo për keq?
- A ka ndryshuar në ndonjë farë mënyre perceptimi i burrave dhe grave (normat, stereotipet, vlerat) gjatë ecurisë së zbatimit të politikës?
- Në rast se objektivat e barazisë gjinore janë shprehur gjatë fazës së planifikimit, në çfarë mase janë arritur këto objektiva?
- A ka pasur politika ndonjë efekt gjinor të papritur apo të rastësishëm?



KUJTONI:

Në secilën prej këtyre fazave, analiza gjinore (informacion + analizë + këndvështrim gjinor) mund t'iu ndihmojë të gjeni përgjigjet për këto pyetje.

3.4. Cilat janë pyetjet që duhet të studioni gjatë analizës gjinore
Përcaktimi i pyetjeve që duhet të studioni, është hapi tjetër i rëndësishëm në kryerjen e analizës gjinore. Këto pyetje përcaktojnë se çfarë kërkoni të zbulojë apo provojë analiza juaj. Këto pyetje duhet të lidhen me përmasat e ndryshme gjinore të çështjes që keni në studim. Gjithashtu, pyetja “Kur duhet të përdor analizën gjinore?” mund t’iu ndihmojë të përcaktoni llojet e pyetjeve që duhet t’iu japë përgjigje studimi juaj, të cilat mund t’i përdorni për faza të ndryshme të projektit apo në ciklin e politikave.

Le të ndalemi më konkretisht në një shembull:

“Pyetje për studimin e analizës gjinore të partneritetit komunitet-polici”.

Një bashki ka alokuar burime për një iniciativë të re e cila synon të ndërtojë një bashkëpunim më të fortë midis njësisë së policisë lokale dhe komunitetit që i shërben. Aktualisht ka një besim të pakët në forcën e policisë, dhe komuniteti nuk e ndjen se po i plotësohen nevojat. Qëllimet e kësaj iniciative janë

- ta bëjë forcën e policisë më të përgjegjshme ndaj nevojave të komunitetit dhe
- të përmirësojë imazhin e forcës së policisë në sytë e komunitetit.

Ka disa pyetje studimore të analizës gjinore që mund të identifikoni në fazat e ndryshme të ciklit të këtij projekti:

- Planifikimi
 - A ka policia një politikë dhe strategji të deklaruar për barazinë gjinore?
 - Nga pikëpamja e atyre që përdorin shërbimet e policisë, burrat dhe gratë, a kanë të njëjtat nevoja?
 - A kanë qëndrime të ndryshme burrat dhe gratë ndaj forcës së policisë?
 - A i trajton policia burrat dhe gratë në të njëjtën mënyrë?
 - Çfarë trajnimi i posaçëm apo ndonjë ndërhyrje tjetër mund të nevojiten për ta bërë forcën e policisë më të përgjegjshme për

plotësimin e nevojave të veçanta si të burrave dhe të grave?

- Zbatimi dhe monitorimi
 - Cila është sasia dhe cilësia e pjesëmarrjes së burrave dhe grave në të gjitha aspektet e zbatimit të projektit? (Vini re se grupet e synuara përfshijnë si komunitetin ashtu edhe forcën e policisë. Pjesëmarrja e burrave dhe grave në të dy këto grupe duhet pasur parasysh).
- Vlerësimi
 - Sa efektive ka qenë nisma në plotësimin e nevojave të burrave dhe grave – si në komunitet ashtu edhe në forcat e policisë?
 - Sa ka ndryshuar perceptimi i grave për forcat e policisë? Po perceptimi i burrave?

Pasi t’i keni përcaktuar pyetjet që do të studioni, ato do t’iu udhëheqin në të gjitha vendimet që do të merrni në lidhje me kërkimet, metodologjinë dhe arritjet.

Analiza gjinore - Çfarë duhet pyetur.

- Cili është target grupi (direkt dhe indirekt) i politikës së propozuar, programit apo projektit? Gratë, burrat apo të dy? Kush do të përfitojë, kush do të humbasë? Cilat gra? Cilët burra?
- A janë këshilluar gratë edhe burrat për “problemin” si dhe ndërhyrjen për ta zgjidhur atë? Si janë përfshirë gratë edhe burrat në gjetjen “e zgjidhjes së problemit”?
- A e sfidon kjo ndërhyrje ndarjen gjinore të detyrave, përgjegjësi dhe burimeve mes grave dhe burrave?
- Cilat nevoja të grave dhe burrave do të adresohen nga ndërhyrja: nevojat praktike, interesat strategjike apo të dyja?
- Cila është marrëdhënia mes ndërhyrjes së propozuar dhe veprimtarive të tjera, si dhe organizatave të tjera kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare?
- Ku ekzistojnë mundësitë për ndryshim apo ndërhyrje? Si mund të përdoren ato?
- Cilat mekanizma të veçanta mund të propozohen për të aftësuar gratë të marrin pjesë në iniciativat politike apo programet,

megjithë pozicionin e tyre tradicional edhe të nënshtruar?

- Cili është ndikimi afatgjatë përsa i përket rritjes së aftësive që të marrin në kontroll jetën e tyre si dhe të ndërmarrin veprime të përbashkëta për zgjidhjen e problemeve?
- Cila është mënyra më e mirë për të ndërtuar dhe fuqizuar përkushtimin e qeverisë për përparimin e grave?
- Këto pyetje paralelisht dhe me ato që u renditën më sipër janë pyetjet bazë gjatë bërjes së një analize gjinore.

3.5. Bërja e “pyetjeve gjinore”

Një mënyrë për ta trajtuar analizën e të dhënave dhe informacionit nga këndvështrimi gjinor, është me anë të bërjes “së pyetjeve gjinore”. Kjo do të thotë të përdorni mënyrën tuaj të të kuptuarit të teorisë bazë gjinore për të bërë pyetje për dallimet mes burrave dhe grave, që dalin në pah nga të dhënat që keni.

Teoria bazë gjinore mund t’ju sugjerojë shpjegime të mundshme për këto dallime. Duke i formuluar këto sugjerime në pyetje përkatëse, mund të siguron një kuadër për drejtimin në të cilin duhet të ecë analiza gjinore. Hapi tjetër i analizës gjinore është t’i ndjekë këto pyetje me anë të testimit të tyre, duke përdorur një metodologji të shëndoshë kërkimore. Shpesh analiza tradicionale nuk i merr parasysh pabarazitë gjinore dhe ndikimin me bazë gjinore, sepse këto fenomene shpesh nuk janë të dukshme në vështrim të parë (ose ne jemi kaq të mësuar me to, sa që nuk i vëmë më re). Për këtë arsye, një pyetje gjinore duhet të shohë përtej presupozimeve tona dhe perceptimeve “standarde”.

Për shembull, pyetjet gjinore bëhen:

- Cilat janë pabarazitë gjinore të mundshme që fshihen nën sipërfaqe?
- Cilat mund të jenë arsyet komplekse të dallimeve gjinore?
- Cilët mund të jenë efektet komplekse të pabarazive gjinore?

Me fjalë të tjera, pyetjet gjinore janë pyetje të cilat përdorin teori gjinore bazë për të ngritur hipoteza të arsyeshme për natyrën, shkaqet dhe pasojat e pabarazive gjinore. Këto pyetje pastaj mund të bëhen shumë më të veçantë, në varësi të situatës konkrete. Le të shikojmë shembujt e mëposhtëm:

Shembull 1: Burrat dhe gratë kanë qasje të njëjtë në burimet pa pagesë të internetit në komunitet. Gjithsesi, këto shërbime përdoren kryesisht nga burrat.

Burimet: përfshijnë burime materiale, por edhe kohë, njohuri dhe informacione. Për shkak të roleve të tyre të shumëfishta në shtëpi dhe në komunitet, shpesh gratë janë “të varfra në kohë” – por ndërkohë ato janë të pasura me njohuri dhe përvojë, të cilat nuk vlerësohen gjithnjë.

Kultura, qëndrimet dhe stereotipet ndikojnë thellësisht në qasjen dhe kontrollin e burimeve.

Çfarë do të thotë “qasje e barabartë”? Për shembull:

- A kanë të njëjtat aftësi për të përdorur internetin si burrat edhe gratë, apo të njëjtat mundësi t’i përftojnë këto aftësi?
- A janë të përdorshme burimet e internetit në kohën që u përshtatet grave?
- A është vënë njëllë në dispozicion të burrave dhe grave informacioni për këto shërbime?
- Çfarë normash kulturore dhe qëndrimesh ekzistuese dalin si pengesë për gratë që në mungesën e tyre do të kishin mundësi t’i përdorin këto shërbime?

Shembull 2: 80 për qind e burrave dhe grave deklarojnë se besojnë në barazinë gjinore.

Struktura e pushtetit me bazë gjinore është sistemike- që do të thotë se ajo iu jep formë institucioneve dhe sistemeve ku marrim pjesë, edhe kur si individë mbështesim barazinë gjinore.

- A i korrespondon sjellja konkrete e burrave dhe grave angazhimit

të tyre ndaj barazisë gjinore?

- Çfarë veprimesh ndërmarrin individët për të kundërshtuar pabarazitë e rrënjësura në sistemin dhe institucionet e tyre?



VINI RE:

Në të dy shembujt, pyetjet gjinore të formuluar mirë, të mbështetura në teori gjinore përkatëse, mund të ndihmojnë për të rrënuar nën sipërfaqen e të dhënave dhe informacionit për të nxjerrë në pah aspektet e fshehura apo të pa vëna re të pabarazive gjinore. Këto pyetje pastaj tregojnë rrugën në të cilën duhet të ecë analiza gjinore dhe në këtë mënyrë ndihmojnë të përcaktohet natyra e politikave që duhen formuluar.

Nxjerrja e përfundimeve

Ndërsa bërja e pyetjeve të efektshme gjinore ndihmon të kanalizohet analiza gjinore në drejtimin e duhur, një analizë e mirë gjinore duhet të kërkojë t'iu japë përgjigje këtyre pyetjeve. Një problem i zakonshëm me kërkimet gjinore është se shpesh studimet përshkruajnë gjendjen dhe vënë në dukje dallimet midis burrave dhe grave, por nuk trajtojnë shkaqet rrënjësore që përjetësojnë pabarazinë gjinore dhe diskriminimin. Ato duhet të pyesin: Përse ekzistojnë këto dallime midis burrave dhe grave? Çfarë është e rëndësishme në këto dallime?

Dy parimet e mëposhtme duhen përdorur si udhëzues për të siguruar që edhe analiza gjinore po ashtu të nxjerrë përfundimet e duhura që mund të përdoren për të adresuar veprime të mëtejshme.

1. Parimi “Cili-Përse” i analizës gjinore.

Analistët duhet të vënë në dukje se cili është ndryshimi midis burrave dhe grave, por ajo që ka më rëndësi, të thonë se përse

ekziston një ndryshim i tillë. Një analizë e mirë gjinore duhet të shkojë përtej përshkrimit të gjendjes me të dhëna statistikore. IMI SHEMBULL: Të thuash vetëm se gratë përfaqësojnë 38 për qind të popullsisë që është aktive ekonomikisht, nuk do të thotë t'i vësh në dukje arsyet e rëndësishme të ekzistencës së kësaj barazie. A shkaktohet ajo nga pengesa kulturore, diskriminimi i drejtpërdrejtë në forcën e punës, mundësi të kufizuara që rrjedhin nga nivelet e ulëta të arsimit, varfëria, shëndeti i keq, përgjegjësia për punë të papaguar? Bëni kontrolle të dyfishta me të dhëna të tjera për të mbështetur pretendimet tuaja. Politikat duhet të mbështeten në fakte, jo në hamendësime. Në rast se nuk njihen shkaqet, duhen ndërmarrë studime të mëtejshme. Megjithatë, po të merrni parasysh teoritë e përkatësisë gjinore, përfundimet që mund të nxirrni, mund t'ju sugjerojnë një hipotezë. Mund të arrini, për shembull, në këtë përfundim: “Ndonëse nuk është kryer ndonjë studim për shkaqet e këtyre pabarazive, pjesëmarrja e pakët e grave ka të ngjarë të shkaktohet nga diskriminimi i drejtpërdrejtë në strukturën e forcës së punës, sikurse edhe nga normat e ngulitura kulturore, të cilat nuk i nxisin gratë të marrin pjesë në forcën e punës që shpërblehet. Duhet ndërmarrë studime të mëtejshme për të identifikuar shkaqet e sakta të këtij fenomeni.” Në këtë mënyrë, mund t'iu edukoni politikë-bërësit për efektet e mundshme “zinxhir” të dallimeve dhe pabarazive gjinore.

2. Parimi “e çfarë, pastaj?” i analizës gjinore.

Përshkrimi apo vënia në dukje e pabarazive gjinore duhet shoqëruar me një analizë të ndikimit të tyre në zhvillimin njerëzor. Ndryshe, hartuesit e politikave mund të thonë: “Po, ka një dallim, e çfarë pastaj?” Për fat të keq, disa hartues politikash (gabimisht) besojnë se pabarazi të tilla janë vetëm pasqyrim i dallimeve të “natyrshme” gjinore dhe se efekti i pabarazive të tilla është i mirë, ose edhe pozitiv. Analiza gjinore duhet të theksojë ndikimin e këtyre pabarazive në zhvillimin e përgjithshëm njerëzor, me qëllim që të hartohen ndërhyrjet e përshtatshme në politika.

SHEMBULL: Në rast se studimi që keni kryer nxjerr në pah se gratë nuk janë përfshirë në diskutime për një projekt lokal të pastrimit të një baseni ujor, çfarë ndikimi do të ketë kjo jo vetëm tek gratë që janë lënë jashtë tij, por në të gjithë gjendjen e përgjithshme të zhvillimit? Këtu janë kufizuar jo vetëm të drejtat e grave për të marrë pjesë, por ky përjashtim do të ndikojë negativisht në arritjet e projektit. Për shkak të njohurive, ideve, dhe aftësive unike që u jep grave roli i tyre në shtëpi dhe në komunitet për përdorimin e ujit dhe mbrojtjen e mjedisit, mospërfshirja e këtij këndvështrimi do të shpjë në zgjidhje më pak të efektshme dhe më pak të qëndrueshme. Një analizë e mirë gjinore duhet të specifikojë, dhe kur është e mundur, të përcaktojë shkallën e kësaj kostoje.



VINI RE:

Përshkrimi i gjendjes së burrave dhe grave duhet të shoqërohet me përfundime thelbësore. Vetëm atëherë analiza gjinore do të jetë me përfitimin maksimal si për burrat, edhe për gratë, që janë përfituesit e synuar të politikave dhe projekteve.

3.6. Kush është përgjegjës për kryerjen e analizës gjinore?

Në varësi të situatës, individë apo grupe të ndryshme mund të jenë përgjegjës për kryerjen e analizës gjinore. Kjo përfshin:

Brenda projektit:

- Anëtarët e stafit që drejtojnë një portofol të caktuar, ose një përgjegjës projekti apo individ përgjegjës për politikën/programin.
- Një specialist të çështjeve gjinore me të cilin punohet. Jashtë:

- Një studiues i veçantë apo një specialist i çështjeve gjinore
- Një grup studimor, një qendër kërkimore, një qendër akademike ose një grup tjetër të pavarur.

Ose, mund t'i gërshetoni këto opsione ose mund të angazhoni një ekip studiuesish.

Kini parasysh listën e mëposhtme të kontrollit përpara se të vendosni se kush do ta bëjë analizën.

- A kam qasje në informacionin e duhur për të kryer analizën gjinore, pra, informacion dhe të dhëna të ndara sipas seksit?
- A kam njohuri të mjaftueshme për teorinë gjinore bazë?
- A i kuptoj këto teori gjinore në lidhje me politikën apo projektin në fjalë, me fjalë të tjera, si mund të jetë përkatësia gjinore një aspekt i rëndësishëm (ndonëse shpesh i fshehtë) i kësaj çështje?
- A kam kohë (apo burime të tjera të nevojshme) për të kryer analizën gjinore ashtu si duhet?
- A do të jetë analiza gjinore e besueshme në sytë e gjithë palëve të interesuara? (Ndonjëherë është e dëshirueshme të bëhet një analizë e pavarur, sidomos kur pozita juaj si analizues në qeveri ose në një institucion financues mund të komprometojë neutralitetin tuaj).

Kryerja vetë e analizës si pjesë e detyrave të projektit mund të duket opsioni me kosto më të efektshme. Megjithatë, ky opsion mund të mos jetë gjithnjë i dëshirueshëm ose i mundshëm.

Kushdo që kryen studimin duhet të zotërojë këto aftësi:

- ekspertizë thelbësore për sektorin apo çështjen politike (p.sh. në makroekonomi, çështje mjedisore, çështje arsimore, etj.).
- ekspertizë gjinore (p.sh., trajnim profesional apo dhe akademik për teorinë gjinore që lidhet me politikën publike).
- ekspertizë teknike e veçantë, siç kërkohet nga çështja studimore (p.sh. përgatitja e vrojtimit, intervistimi, shembuj nga ekonomia, analizë të kostos, etj).
- besueshmëri në sytë e të gjithë palëve të interesuara.



MBANI MEND:

Baraspesha e duhur e këtyre elementëve është e qenësishme për të dalë me opsione të dobishme dhe të pranueshme politikash. Nëse analiza gjinore kryhet nga ju apo nga dikush tjetër, kjo mund të kërkojë që të angazhoni një ekip kontribuesish për të nxjerrë maksimumin e përvojës, ekspertizës dhe këndvështrimeve që do t'i japin formë analizës.

Metodologjia e analizës gjinore

Për qëllime të ndryshme, mund të përdoren përfaqse të ndryshme të analizës gjinore. Analiza gjinore mund të jetë një ushtrim i shpejtë dhe i pakushtueshëm, ose mund të kërkojë shumë kohë dhe burime. Si planifikues politikash apo projektsh, duhet të vendosni për shkallën dhe nivelin e përshtatshëm të analizës në një situatë të caktuar – me fjalë të tjera, duhet të zgjidhni metodologjinë e përshtatshme. Ja tre shembuj të tre metodologjive të ndryshme të analizës gjinore dhe të objektivave që mund të realizojnë ato: ÇFARË?KUSH? SI? PËRSE?

A. Studim në tavolinë (desk research)

Planifikuesi i projektit/politikës + njohuri bazë (pra përdorimi "i pyetjeve gjinore" në të dhënat/njohuritë ekzistuese).

Përgjithësisht, ky është niveli më pak intensiv i analizës gjinore. Kur informacioni gjendet me lehtësi, dhe kur keni një kuptim të qartë të lidhjes së teorive bazë gjinore me gjendjen konkrete, mund të jeni në gjendje të bëni vetë një analizë gjinore të mjaftueshme.

B. Ushtrimi në një grup

Një numër palësh të interesuara (burra dhe gra) duke përfshirë edhe ata me përvojë gjinore. Bërja e "pyetjeve gjinore" si grup dhe dhënia e përgjigjeve për to, mbështetur në njohuritë ekzistuese të grupit. Kjo kërkon më tepër punë se një rishikim nga tavolina, por megjithatë e justifikon koston dhe mund të sigurojë analizë dhe rezultate të thella. Përfshirja e palëve të interesuara të projektit apo politikës, siguron artikulin e nevojave konkrete të burrave dhe grave. Përfshirja në grup e një eksperti të çështjeve gjinore do të ndihmojë për identifikimin dhe zbatimin e teorisë dhe analizës së nevojshme gjinore të situatës konkrete.


C. Projekt studimor në thellësi ose vrojtim sociologjik

(1) Analiza e të dhënave statistikore dhe të dhënave të tjera; ose (2) mbledhja e të dhënave të reja për të siguruar bërjen e një analize "të çështjeve gjinore" të përcaktuara në termat e referencës. Një projekt i tillë kërkon më shumë kohë dhe burime se sa ato që shprehen në opsionin A ose B. Ai kërkon një nivel të sofistikuar analize dhe ekspertize. Megjithatë, rezultati është një analizë e hollësishme që mund të na japë një ide të situatës nga këndvështrimi gjinor. Në vend të hamendësimeve të arsyeshme apo hipotezave për ndikimin gjinor, studimet në thellësi mund t'i vërtetojnë këto pretendime me një metodologji të shëndoshë shkencore.

Një analizë gjinore na mundëson që të identifikojmë dallimet mes grave dhe burrave në lidhje me veprimtaritë, kushtet, nevojat, aksesin dhe kontrollin e tyre të veçantë të burimet, dhe aksesin të përfitimit e zhvillimit dhe vendimmarrjes.

Tabela 3: Koncepte dhe instrumente analitike të analizës gjinore

FAKTORËT NDIKUES	<ul style="list-style-type: none"> ● socialë ● ekonomikë ● politikë ● mjedisorë ● ligjorë ● kulturorë etj.
NDARJA GJINORE E ROLEVE/PUNËVE	<ul style="list-style-type: none"> ● shpërndarje sezonale ● përdorimi i kohës ● ngarkesa e punës ● riprodhues/prodhues ● menaxhim komuniteti/politika ● e paguar/e papaguar
AKSESI TE/KONTROLLI MBI BURIMET	<ul style="list-style-type: none"> ● natyror ● fizik ● jomaterial ● njerëzor ● tregu ● socio-kulturor
KAPACITETI VENDIMMARRËS	<ul style="list-style-type: none"> ● nivel familjar ● nivel politik (komunitet dhe shtet) ● organizata komunitare formale dhe joformale
NEVOJAT GJINORE	<ul style="list-style-type: none"> ● nevoja praktike ● nevoja strategjike
ANALIZA INSTITUCIONALE	<ul style="list-style-type: none"> ● politikat dhe shërbimet ● struktura organizative ● kualifikimet e stafit/personeli
QASJA POLITIKE	<ul style="list-style-type: none"> ● ndihmë sociale ● drejtësi ● kundër varfërisë ● efikasitet ● fuqizim
NIVELI I PJESËMARRJES	<ul style="list-style-type: none"> ● bamirësi ● marrje e përfitimeve ● kontribut në punë ● këshillim i problemit ● fuqizim



KAPITULLI 4

BUXHETIMI DHE MONITORIMI

4.1. Monitorimi, vlerësimi dhe llogaridhënia

Në kushte ideale, cikli i buxhetit duhet të përmbajë një hallkë për komente dhe mendime që të lejojë që mësimet e nxjerra nga buxhetet aktuale të përdoren për informacionin e përgatitjes dhe zbatimit të buxhetit të ardhshëm. Për sa i takon monitorimit dhe vlerësimin, duhet të ketë kontrolle për të parë nëse paratë janë shpenzuar sipas planit. Raste të shpenzimeve të tepërta ngrenë pyetje rreth burimit të parave – cilat programe humbën para që programet e tjera të mund të shpenzonin më shumë. Rastet e shpenzimeve më të pakta, ngrenë pyetje pritshmërisht – cilët përfitues potencialë nuk morën shërbime për shkak se qeveria nuk i shpenzoi paratë e caktuara për ta dhe cilat ishin arsyet e mos shpenzimit.

Përveç krahasimit të sasive të parave të shpenzimeve aktuale përkundrejt shpenzimeve të planifikuara, efektiviteti i buxhetit bën të mundur të bëhet krahasim midis produkteve aktuale të siguruar përkundrejt objektivave të planifikuara – për shembull, sa nxënës u mësuan, sa pacientë u trajtuan në spitale dhe klinika apo sa shtëpi u furnizuar me elektricitet dhe ujë. Ky lloj monitorimi synon të masë efektivitetin dhe eficientësinë. Në rast se produktet dhe synimet janë të ndara, për shembull, sipas gjinisë apo rajonit, monitorimi mund të masë edhe barazinë e tyre.

Caktimi i shpenzimeve të posaçme për gjininë

Kjo gjë përfshin një vlerësim të alokimeve që synojnë posaçërisht gjininë përmes:

- identifikimit të qëllimit të programit apo projektit të listuar, duke përfshirë problemin që duhet trajtuar;
- identifikimit të veprimtarive të planifikuara për të zbatuar programin apo projektin;
- përcaktimit të sasisë së burimeve të alokuara;
- përcaktimit të treguesve të produkteve (p.sh. numri i grave apo burrave përfitues);
- përcaktimit të ndikimit të treguesve të produkteve, për të matur ndryshimet e gjendjes së grave, burrave, vajzave dhe djemve;
- marrjen parasysh të ndryshimeve të planifikuara për vitin e ardhshëm, për të vlerësuar nëse buxheti po bëhet pak a shumë i ndjeshëm ndaj gjinisë.

Mundësi të barabarta punësimi në sektorin publik

Çështjet e mundësisë së barabartë në punësimin në sektorin publik janë analizuar përmes:

- përshkrimin të modeleve të punësimit në një sektor (apo sektorë) të caktuar, apo në përgjithësi në sektorin publik; duke i ndarë sipas seksit, niveleve të punësimit (fazë), formave të

48 BUXHETIMI I PËRGJIGJSHËM GJINOR NË SHQIPËRI

- punësimin (me orë të plota apo të pjesshme, të përhershme apo të përkohshme), pagave dhe përfitimeve. Gjithashtu mund të përfshihen edhe ndarje të tilla si raca dhe paaftësia;
- identifikimit të iniciativave konkrete për të nxitur mundësi të barabarta punësimi –sasive të shpenzuara dhe numrave të arritur (p.sh. gra në trajnime për menaxhim apo trajnim për gjininë për zyrtarët);
- përcaktimit të numrit të grave dhe burrave në pozita me përqendrim apo specializim gjinor (p.sh. pikat fokale gjinore, policia, zyrtarë të mjekësisë dhe të ndihmës ekonomike që merren me përdhunimet dhe dhunën në familje; apo burrave në pozita që merren me burrat dhe dhunën me bazë gjinore);
- ndarjes sipas seksit dhe anëtarësia në borde dhe komitete të ngritura sipas sektorit (sektorëve) (duke bërë dallim midis mundësive të paguara dhe të papaguara dhe niveleve të shpërblimit);
- përshkrimin të ndryshimeve të planifikuara për vitin e ardhshëm.

Në punën e buxhetit gjinor, çështjet gjinore në punësimin në sektorin publik mund të shihen në dy mënyra. Së pari, pagat përfaqësojnë një përqindje të madhe të shumicës së buxheteve. Modelet e punësimin në shërbimin publik tregojnë se kush përfiton drejtpërdrejt nga këto paga. Modelet në këtë mënyrë pasqyrojnë (ose jo) parimet e mundësive të punësimin të barabartë midis burrave dhe grave dhe midis grupeve të burrave dhe grave. Së dyti, prania e grave apo burrave në pozita të caktuara mund të ndikojnë në reagimin gjinor të vendimmarrjes dhe sigurimit të shërbimeve.

Alokime për shërbime të përgjithshme

Alokimet e përgjithshme apo kryesore mund të analizohen në mënyrë të ngjashme me alokimet e posaçme gjinore. Megjithatë, zakonisht ka shumë programe dhe projekte brenda një sektori të caktuar, prandaj duhen bërë zgjedhje se ku duhet përqendruar. Kriteret e dobishme në bërjen e këtyre zgjedhjeve janë madhësia (në

këndvështrim të buxhetit) e programeve të ndryshme, dhe rëndësia e nga këndvështrimi gjinor i çështjeve që ata trajtojnë.

4.2. Përqasja me pesë hapa



PESË HAPAT JANË:

- 1 Analiza e situatës së grave, burrave, vajzave dhe djemve
- 2 Vlerësimi i politikave të ndjeshme ndaj çështjeve gjinore
- 3 Vlerësimi i akordimeve të buxhetit
- 4 Monitorimi i shpenzimeve dhe realizimi i shërbimeve
- 5 Vlerësimi i rezultateve

Analiza e situatës së grave, burrave, vajzave dhe djemve -Një nga produktet e punës për buxhetin gjinor është zbulimi i pamjaftueshmërisë së të dhënave të ndara sipas gjinisë për gjendjen krahasuese të grave dhe burrave, vajzave dhe djemve sipas sektorëve të ndryshëm. Situata e kufizon shumë mundësinë që kanë personat e përfshirë për të përcaktuar dhe për t'iu përgjigjur rasteve ku gjinitë janë në pozita të pafavorshme gjinore. Në të gjitha vendet, disavantazhi gjinor bashkëjeton me të gjitha format e tjera të disavantazheve. Për shembull, në shumicën e vendeve, njerëzit që banojnë në fshat do të jenë në pozitë më të pafavorshme krahasuar me popullsinë e qytetit dhe të varfër, krahasuar me të pasurit. Zakonisht ka edhe disavantazhe të tjera konkrete për çdo vend për sa i takon racës, etnisë, moshës dhe kështu me radhë. Këto akse të tjera të disavantazheve duhen

marrë parasysh kur mblidhet informacion për vlerësimin e situatës gjinore, meqenëse ka të ngjarë që të ketë dallime të mëdha midis grave dhe vajzave të nëngrupeve të ndryshme, sikurse ka midis burrave dhe djemve nga nëngrupe të ndryshme.

Mbledhja e informacionit që nevojitet për të analizuar situatën e grave, burrave, vajzave dhe djemve (dhe nëngrupet e ndryshme të tyre) mund të bëhet përmes bashkëndimit të burimeve kombëtare (lokale) dhe ndërkombëtare që përfshijnë përmbledhje ndërkombëtare, të dhëna statistikore nga i gjithë vendi, plane kombëtare zhvillimi, dokumente politikash të qeverive, statistika zyrtare të qeverisë, të dhëna administrative dhe studime të pavarura. Për shkak të historisë së paragjykimeve gjinore kundër femrave, shumica e dokumenteve që analizojnë situatën gjinore i përqendrojnë konstatimet e tyre në statusin e grave dhe vajzave.

Burimet e vendit për të dhënat dhe informacionet gjinore

Këto përfshijnë:

- të dhënat për regjistrimin e popullsisë;
- vrojtimit e familjeve;
- shërbimin kombëtar statistikor;
- makinerinë kombëtare të grave ;
- agjencitë sektoriale për të dhënat administrative;
- departamentet e universiteteve, institutet kërkimore dhe bibliotekat;
- organizatat e grave dhe organizata të tjera të shoqërisë civile (OJQ-të);
- qendra studimore dhe institute kërkimore të pavarura.

Rekomandime për të dhëna bazë të ndara sipas gjinisë

Agjencia Suedeze e Statistikave, në botimin e saj Engendering Statistics: A Tool For Change [Gjinizimi i Statistikave: Një Instrument për Ndryshim], sugjeron se informacioni bazë i ndarë sipas seksit

duhet të jetë i disponueshëm me qëllimin që të maten shkaqet kryesore të problemeve gjinore, pasojat dhe efektet gjinore. Lista më poshtë është një përshtatje e rekomandimeve të tyre, të cilët mund të jenë tregues të dobishëm për punën me buxhetimin gjinor.

Ndarja sipas seksit në arsim:

- Përqindjet e regjistrimit në nivelin fillor;
- Përqindjet e regjistrimit në nivelin bazë;
- Përqindjet e regjistrimit në nivelin e shkollës së mesme;
- Përqindjet e regjistrimit në nivele të treta;
- Përqindjet e regjistrimeve në arsimimin për të rritur;
- Regjistrimi në arsimin e mesëm dhe të tretë sipas fushës së studimit;
- Nivelet e arsimit të përfutur nga popullsia e rritur (18 vjeç e më shumë);
- Ndryshimet urbane/rurale në nivelin e regjistrimeve në arsimin fillor, të mesëm, dhe të tretë;
- Shkalla e lënies së shkollës, mungesave, dhe përsëritjes së klasave në shkolla.

Ndarja e pabarabartë e përgjegjësisë në familje:

- Koha e shpenzuar për punë të paguar dhe të papaguar sipas statusit martesor, moshës, dhe numrit e moshës së fëmijëve
- Popullsia e papunë sipas statusit martesor, moshës, dhe numrit e moshës së fëmijëve
- Koha e shpenzuar nga fëmijët që punojnë në familje dhe/ose në bujqësinë për nevojat vetjake.

Roli Riprodhues i Grave:

- Shkalla e përgjithshme e pjellorisë;
- Shkalla e pjellorisë sipas moshës, statusit martesor dhe vendndodhjes urbane/rurale;
- Popullsia ekonomiksht aktive/jo aktive sipas statusit martesor dhe numrit të fëmijëve.

Qasja e grave në strehë:

- Kufizime në pronësi/pronësi shtëpish
- Kryefamiljari i shtëpisë sipas statusit martesor
- Pronësia ligjore apo pronësia e përbashkët sipas statusit martesor
- Banim me familje të zgjeruara apo marrëdhënie të tjera sipas statusit martesor.

4.3. Treguesit**Çfarë janë treguesit?**

- Një tregues është një piketë. Mund të masë një numër, një fakt, një opinion, apo perceptim që piketon një kusht a situatë të veçanta dhe mat ndryshimet në atë kusht a situatë me kalimin e kohës.
- Treguesit mund të shprehin edhe "hendeqe" mund të formulohen në formën e një pyetjeje: "A kanë arritur shpenzimet sipas politikës X në banesat me kryefamiljare femra?", për shembull.
- Me fjalë të tjera, treguesit ofrojnë një vështrim nga afër të rezultateve të nismave e veprimeve. Për këtë arsye, ato janë instrumente të dorës së parë për të monitoruar dhe vlerësuar zbatimin e një politike nga pikëpamja thelbësore dhe financiare (nëpërmjet buxhetit).
- Treguesit me ndjeshmëri gjinore kanë funksionin e posaçëm të vënies në dukje të ndryshimeve me lidhje gjinore në shoqëri me kalimin e kohës. Dobia e tyre qëndron në aftësinë e tyre për të vënë në dukje ndryshime në statusin dhe rolet e grave dhe burrave me kalimin e kohës dhe për rrjedhojë, për të matur nëse po arrihet barazia gjinore.
- Për shkak se përdorimi i treguesve dhe teknikave të tjera përkatëse të vlerësimit çon në të kuptuarit më të mirë se si mund të arrihen rezultatet, përdorimi i treguesve me ndjeshmëri gjinore do të jetë me dobi edhe për planifikimin e ardhshëm dhe realizimin e programeve në mënyrë më të efektshme (CIDA, 1997).

- Prandaj, është e domosdoshme që të zhvillohen tregues për të monitoruar zbatimin e një politike nga një perspektivë gjinore, por edhe për të monitoruar lehtësisht zbatimin e buxhetit të një politike.

Treguesit e mirë duhet të jenë:

- të lidhur me politikën, duke qenë në gjendje të ofrojnë përgjigje të qarta dhe jo të mjegullta ndaj çështjeve dhe shqetësimeve të politikave kyçe ;
- të lidhura me angazhimet kombëtare dhe lokale ndaj barazisë gjinore;
- të kenë përdoruesin në mend ,të jenë të kuptueshme në kohë, dhe të pakta në numër ;
- të nxjerra nga një kuadër, i cili lejon interpretimin e një shifre (le të themi regjistrimit) në kontekstin e variableve të tjera bazë (të tilla si demografia dhe investimi në arsim) të një vendi të caktuar;
- të shëndoshë teknikisht – të vlefshëm, të besueshëm, të matshëm dhe të krahasueshëm;
- duhet të masin hendekun paraekzistues gjinor që politika dhe buxheti po përpiqen të trajtojnë.

Treguesit "**me përgjigjshmëri gjinore**", "**me ndjeshmëri gjinore**", apo thjesht 'gjinorë' matin ndryshimet që lidhen me gjininë me kalimin e kohës. Këta tregues mund të jenë sasiorë, që mbështeten në të dhëna statistikore të ndara sipas gjinisë,të cilat mund të maten ndarazi për burrat dhe gratë, për shembull matja e aftësive të leximit dhe shkrimit. Treguesit e barazisë gjinore mund të ngërthejnë gjithashtu edhe ndryshime cilësore,për shembull, rritjen e niveleve të fuqizimit të grave apo ndryshimet në qëndrimet ndaj barazisë gjinore. Matjet e barazisë gjinore mund të trajtojnë ndryshimet në marrëdhëniet midis grave dhe burrave, rezultatet që sjell një politikë, program, apo veprimtari e caktuar për gratë dhe burrat, apo ndryshimet në statusin apo gjendjen e grave dhe të burrave, si për shembull nivelet e varfërisë apo të pjesëmarrjes.

Tabela 4.

METODOLOGJIA	PËRKUFIZIMI I PËRDORUR
Sasiore	Metodat sasiore të mbledhjes së të dhënave prodhojnë rezultate në formën e sasive të matshme. Ato përqendrohen tek të dhënat që përbëjnë sasi të numërueshme, si, për shembull, përqindja e grave dhe burrave në parlament, nivelet e pagave ndër gratë dhe burrat, apo numri i vajzave dhe djemve të regjistruar në shkollë. Të dhënat sasiore mund të tregojnë ndryshime në barazinë gjinore me kalimin e kohës, për shembull, një tregues sasiore që përdoret rëndom është numri i vajzave që ndjekin shkollën, krahasuar me djemtë.
Cilësore	Metodologjitë cilësore ngërthejnë përvojat, sjelljet, mendimet, qëndrimet dhe ndjenjat e njerëzve, për shembull, çfarë mendojnë gratë për kufizimet dhe të mirat e të punuarit në sektorin informal, ose mendimet e grave dhe burrave për sa iu përket shkaqeve dhe pasojave të dhunës në familje. Metodologjitë me pjesëmarrje, si diskutimet në grupe të përqendruara apo instrumentet e planifikimit shoqëror, përdoren shpesh për të mbledhur të dhëna për treguesit cilësorë. Të dhënat cilësore mund të mbledhen gjithashtu edhe nëpërmjet anketave që matin perceptimet dhe opinionet.

Metodat me pjesëmarrje janë të dobishme në mbledhjen e të dhënave cilësore. Metodat me pjesëmarrje mbështeten në parimin se gratë dhe burrat duhet të jenë aktorët që e sjellin vetë zhvillimin e tyre duke kontribuar në marrjen e vendimeve se çfarë duhet matur dhe se cilët tregues duhen përdorur.

Shembuj të treguesve me ndjeshmëri gjinore.

Treguesit mund të jenë deklarativë (shih treguesit DhkG), pyetje (shih Treguesit e Punësimit dhe Mbrojtjes Sociale), dhe mund të jenë numerikë ose sasiore.

Disa shembuj treguesish që autoritetet dhe komunitetet lokale mund të përdorin për të matur Punësimin e Gruas dhe Aksesin e Gruas ndaj Mbrojtjes Sociale¹²:

- A marrin gratë shpërblim të barabartë dhe trajtim të barabartë në lidhje me punë me vlerë të barabartë, në sektorin privat?
- Ç'përqindje e forcës punëtore të përgjithshme me pagesë janë gra (me ndarje sipas grupmoshave p.sh. 15-24 vjeç; 25-44 vjeç; 45 vjeç dhe më shumë)
- A kanë burrat dhe gratë të drejta të barabarta për sigurimet

shoqërore, sidomos në raste si: daljeje në pension, papunësie, sëmundjeje, paaftësimosheapo paaftësi të tjera për të punuar?

- Cila është mosha e detyrueshme e pensionit për burrat dhe gratë?
- Cila është mosha e zakonshme vullnetare e pensionit për burrat dhe gratë?
- A kontribuojnë burrat dhe gratë të njëjtat sasi për pensionet e tyre?
- Nëse vendi ka legjislacion për sigurimet shoqërore, a janë të gjitha gratë të mbuluara nga ky legjislacion?
- A përfitojnë bashkëshortet nga planet e pensioneve që mbahen prej bashkëshortëve dhe anasjelltas?
- A siguron Qeveria që të ekzistojnë mundësi punësimi për gratë në vende pune që tradicionalisht nuk kërkohen nga ato?
- A nxiten gratë që të ndërmarrin stazhe në fusha zakonisht të pandjekura nga gratë?
- A ka marrë shteti masat e përshtatshme për të zhvilluar një rrjet mjedisesh përkujdesjeje për fëmijë? Nëse po, a i përbush nevojat ekzistuese?
- A e mbështet qeveria, financiarisht ose ndryshe, kujdesin për fëmijët?

12. <http://www.die.gov.tr/CIN/women/cedawind.htm>

52 BUXHETIMI I PËRGJIGJSHËM GJINOR NË SHQIPËRI

- A kanë gratë të drejtën për përfitime të tilla familjare?
- A merren masa për të siguruar që procesi i aplikimit për përfitime për familjen nuk është diskriminues ndaj grave?
- A e kanë të gjitha gratë në nevojë të drejtën e mundshme për të përfituar nga sigurimet shoqërore?
- A kanë gratë e martuara, në të drejtën e tyre apo si prindër, akses ndaj përfitime të tilla për familje si: pagesa për fëmijët, strehim publik, mbulim nga sigurimet shëndetësore, apo financime a pagesa të tjera qeveritare?

Disa shembuj treguesish që autoritetet dhe komunitetet vendore mund t'i përdorin për të matur DhkG¹³:

- Përqindja e grave në moshën 15-49 vjeç që kanë përjetuar ndonjëherë dhunë fizike nga një partner i afërt.
- Përqindja e grave në moshën 15 – 49 vjeç që kanë përjetuar ndonjëherë dhunë seksuale nga një partner i afërt.
- Përqindja e grave në moshën 15-49 vjeç që kanë përjetuar ndonjëherë dhunë fizike nga dikush tjetër veç partnerit të afërt.
- Përqindja e njërive të shëndetit që kanë dokumentuar dhe përshtatur një protokoll për menaxhimin klinik të të mbijetuarave të DhkG.
- Përqindja e njërive shëndetësore që kanë bërë një vlerësim të gatishmërisë për ofrimin e shërbimeve për DhkG.
- Përqindja e njërive shëndetësore që kanë kushte klinike për menaxhimin klinik të DhkG.
- Përqindja e njërive shëndetësore me të paktën një ofruer shërbimi të trainuar për t'u kujdesur dhe për të referuar DhkG.
- Përqindja e shkollave që kanë procedura për të ndërmarrë veprime për rastet e raportuara të abuzimit seksual.
- Numri i programeve të trajnimit për mësues që përfshijnë DhkG seksuale dhe fizike në programet e tyre mësimore.

13. Bloom, Shelah S. "Dhuna Kundër Grave dhe Vajzave: Një Përmbledhje e Treguesve të Monitorimit dhe Vlerësimit," Tetor 2008.

- Përqindja e shkollave që trajnojnë stafin e tyre mbi çështje të DhkG seksuale dhe fizike.
- Përqindja e njërive ligjzbatuese që ndjekin një protokoll të ngritur në shkallë kombëtare për ankesat për DhkG.
- Numri i ankesave për DhkG raportuar në polici
- Përqindja e rasteve të DhkG që u ndoqën penalisht
- Përqindja e çështjeve DhkG të ndjekura penalisht që çuan në dënim.

Statistikat me bazë gjinore janë një mënyrë për të treguar se si dallimet gjinore mund të ndikojnë në zhvillimin ekonomik dhe shoqërore të shoqërive.

Treguesit e performancës përdoren për të matur dhe monitoruar arritjet e rezultateve të pritura dhe tregojnë suksesin ose mosesuksesin e punës:

- masin inputet, proceset, produktet, rezultatet si dhe ndikimin e projekteve, programeve ose strategjive;
- u mundësojnë drejtuesve të ndjekin progresin e punëve, rezultatet e arritura dhe të marrin veprime korigjuese për të përmirësuar shpërndarjen e shërbimeve.

Shembuj: norma e braktisjes së shkollës për nxënësit e arsimit bazë, niveli i mbulimit të popullsisë me shërbimin e ujit të pijshëm etj.

Shembuj praktik

1.PROGRAMI:Çështjet e përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës

Objekti: Fuqizimi ekonomik i grave nëpërmejt rritjes së aksesit të tyre në skemat e subvencionimit të biznesit të vogël të ofruar nga Bashkia X.

Produkti: Gra të subvencionuara nga Bashkia

Tregues performance:

- % e grave që aplikojnë në skemat e subvencionimit ndaj tërësisë së aplikanteve.
- % e bizneseve të suksesshme në pronësi të grave ndaj tërësisë së bizneseve në Bashkinë X.
- % e bizneseve të falimentuara në pronësi të grave ndaj tërësisë së bizneseve të falimentuara brenda 1 viti në Bashkinë X.
- % e taksave dhe tarifave të paguara nga bizneset në pronësi të grave ndaj tërësisë së taksave dhe tarifave të mbledhura brenda një viti nga Bashkia X.

2. PROGRAMI: Ndrichimi i rrugëve

Objekti: Të mirëmbahet rrjeti ekzistues i ndriçimit publik dhe të mundësohet mbulimi i zonave të reja me ndriçim.

Produkti: Nr i zonave të reja të mbuluara me ndriçim

Treguesi i performancës:

- nr i rasteve të dhunimeve në rrugë;
- nr i grave që jetojnë në këto zona;

3. PROGRAMI: Shërbimet ambulatorie

Objekti: Përmirësimi i shëndetit të nënave të reja dhe fëmijëve, nëpërmjet krijimit të kushteve të përshtatshme në qendrat e kujdesit parësor shëndetësor:

Produkti: Nr i konsultoreve të gruas/fëmijës të rikonstruara/ndërtuara

Tregues performance:

- nr i fëmijëve 0-1 vjeç të asistuar brenda 1 viti nga konsultoret e fëmijës
- nr l grave shtatzëna të asistuar nga konsultorja e gruas brenda 1 viti
- nr l fëmijëve të vaksinuar ndaj tërësisë së fëmijëve në moshë vaksine brenda 1 viti

4. PROGRAMI: Zhvillimi i strehimit

Objekti: Rritja e aksesit të familjeve njëprindërore në skemat e subvencionimit të kredive për shtëpi apo qirave sociale (në vijë me objektivin e MZHU për strehimin social)

Produkti: nr i familjeve njëprindërore që kanë përfituar bonus strehimi

Tregues performance:

- nr familjeve njëprindërore që kanë përfituar bonus strehimi ndaj tërësisë së aplikimeve
- nr i përfituesve të strehimit social tërësisë së kërkesave
- nr i përfituesve të strehimit social ndaj tërësisë së nevojave

5. PROGRAMI: Shërbimet rekreative dhe sportive

Objekti: Rritja e aksesit të vajzave dhe grave në sporte, nëpërmjet shtimit të qendrave shumësportive.

Produkti:

1. fushë voleybolli/basketbolli/tenisi e ndërtuar.
2. Klubi i futbollit për femra i krijuar/i financuar

Tregues performance:

- nr i vajzave që frekuentojnë qendrat sportive ndaj djemve që i frekuentojnë ato
- % e suksesit në sporte të ndryshme e vajzave ndaj djemve (medaljet e fituara)





